



European  
Union  
Kosovo



# Doracak i Përmbledhjes së Praktikave të mira të Zgjidhjeve Paqësore të Konflikteve mes Bashkëmoshatarëve në Shkolla

Prishtinë, Maj 2019



**KEC**

Qendra për Arsime në Kosovë  
Kosova Education Center



forumZFD

PRISHTINË, MAJ 2019

**AUTOR I DORACAKUT:** Petrit Sopjani

**PËRKTHIMI:** LBG Communication

**DIZAJNI DHE SHTYPI:** Envinion

Kjo përmbledhje u hartua në kuadër të projektit “Promovimi dhe Mbrojtja e të Drejtave të Fëmijës” që financohet nga Bashkimi Evropian, menaxhohet nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë dhe zbatohet nga Qendra për Arsim e Kosovës në partneritet me forumZFD në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë-MASHT dhe OSHC-të në Kosovë.

# Përmbajtja

---

## 05 Parathënie

### 07 Pjesa I

- 08 Fuqizimi i mekanizmave brenda shkollës për zgjidhje paqësore të konflikteve ndërmjetësimi mes bashkëmoshatarëve si mekanizëm për të siguruar mbrojtje dhe siguri në shkollë
- 10 Procesi i përkrahjes së shkollave në krijimin e mekanizmave brenda shkollave që promovojnë zgjidhjet paqësore të konflikteve
- 12 Integrimi i planit vjetor të veprimit ndaj rasteve të dhunës dhe plani i ndërmjetësimit mes bashkëmoshatarëve në planin zhvillimor të shkollës
- 13 Informimi dhe aktivizimi i palëve brenda shkollës në krijimin dhe fuqizimin e mekanizmave në shkollë
- 14 Identifikimi dhe analizimi i gjendjes së shkollës në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë në shkolla
- 15 Përzgjedhja dhe përcaktimi i nxënësve që do të përbëjnë ekipet e ndërmjetësimit
- 16 Përgatitja dhe ngritja e kapaciteteve të nxënësve, mësimeve dhe akterëve tjerë për metodologjinë e ndërmjetësimit dhe zgjidhjes paqësore të konflikteve
- 18 Emërimi dhe certifikimi i nxënësve që përbëjnë ekipin për ndërmjetësim
- 19 Krijimi i hapësirës/klasës brenda shkollës për aktivitetet e ndërmjetësimit dhe zgjidhjes paqësore të konflikteve
- 21 Dizajnimi dhe zhvillimi i fushatave vetëdijesuese në shkollë të udhëhequra nga nxënësit
- 22 Përshirja dhe angazhimi i prindërve dhe komunitetit për të kontribuar në aktivitetet e shkollës
- 23 Sigurimi i qëndrueshmërisë së mekanizmave të krijuar brenda shkollës
- 23 Burimet e nevojshme për të zhvilluar aktivitetet e ndërmjetësimit dhe krijimit të kulturës për zgjidhje paqësore të konflikteve në shkollë
- 24 Promovimi i qasjes së zgjidhjes paqësore të konflikteve Aktivitete alternative (jashtë kurrikulare) për të sensibilizuar dhe aktivizuar nxënësit në shkollë

### 25 Pjesa II

- 26 Aktivitetet e ndërmarra nga shkollat për të promovuar zgjidhjen paqësore të konflikteve ndërmjetësimi mes bashkëmoshatarëve

## **27 PRAKTIKAT E MIRA TË REALIZUARA NË SHKOLLA DHE TË PËRKRAHURA NGA OJQ-të**

27 OJQ "Education Comes First", Gjakovë

29 OJQ "Agjensioni për shërbime social edukative "Shpresa e jetës", Prishtinë

31 OJQ "Qendra për dramë dhe aktivitete kreative për fëmijë dhe të rinjë „Qeshu – Smile“, Prishtinë

34 OJQ "Qendra për studime të avancuara"- FIT, Prishtinë

36 OJQ "Mundësia" – Mitrovicë

39 OJQ "Instituti për zhvillim dhe integrim" – IZHI, Prishtinë

41 OJQ "Childproof/CIPOF", Klinë

43 OJQ "Qendra për depolitizimin e shoqërise kosovare" QDSHK – Kamenicë (Novo centar za depolitizaciju kosovskog društva CDKD- Kamenica)

46 OJQ "Feminae", Prizren

48 OJQ "Programi për të drejtat civile"- CRP/K, Prishtinë

## **51 Pjesa III**

52 Aktivitetet që janë realizuar kanë fuqizuar edhe më tepër rolin e OJQ-ve dhe shkollave përfituese në projekt

## **57 Pjesa IV**

58 Materialet dhe web linqet e dobishme për aktivitete ndërmjetësimi

---

## Parathënie

---

Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) dhe forumZFD - Programi në Kosovë kanë bashkëpunuar në zhvillimin e Protokollit për Parandalimin e Dhunës në Institucionet e Arsimit Parauniversitar. Ky protokoll ka për qëllim që në mënyrë efektive të përcakton të gjithë hapat e nevojshëm për të trajtuar temën e dhunës në shkolla. I njejtë Protokoll është miratuar më vonë në formë rregulloreje nga Qeveria e Kosovës - Rregullorja GRK Nr. 21/2013.

KEC dhe forumZFD gjithashtu kanë zhvilluar një program për ndërmjetësimin që është përdorur për të filluar zbatimin e Protokollit në shkolla. Pasi ka bërë hapat e parë të zbatimit të Protokollit në 30 shkolla në Kosovë në kuadër të projektit “Përkrahje për drejtësinë për fëmijët” - Faza III (2013-2016) e financuar nga UNICEF, BE dhe forumZFD; të dy organizatat, KEC dhe forumZFD, kanë vendosur të bashkëpunojnë në zbatimin e këtij projekti, ku nëpërmjet financimit nga BE-ja, dhe në bashkëpunim me 10 OJQ lokale është implementuar projekti **“Promovimi dhe Mbrojtja e të Drejtave të Fëmijës”**.

Ky projekt ka për qëllim fuqizimin e komuniteteve lokale, për t'i përmirësuar masat mbrojtëse për fëmijë nëpërmjet ngritjes së vetëdijes, ndërmjetësimit dhe zgjidhjes paqësore të konflikteve. Përmes kësaj qasje gjithëpërfshirëse projekti synon që të kontribuojë në krijimin


“Projektin synon që të kontribuojë në krijimin e mjediseve miqësore dhe pa dhunë për fëmijët nëpër shkollat e Kosovës, si dhe përmes veprimeve të synuara të organizatave të shoqërisë civile dhe komuniteteve lokale për promovimin e të drejtave të fëmijës.”

e mjediseve miqësore dhe pa dhunë për fëmijët nëpër shkollat e Kosovës, si dhe përmes veprimeve të synuara të organizatave të shoqërisë civile dhe komuniteteve lokale për promovimin e të drejtave të fëmijës.

*Ardita Kabashi  
& Vjollca Islami Hajrullahu  
Menaxhere të projektit*

*“Promovimi dhe Mbrojtja e të Drejtave të Fëmijës”*





**PJESA I**

## 1. Fuqizimi i mekanizmave brenda shkollës për zgjidhje paqësore të konflikteve- ndërmjetësimi mes bashkëmoshatarëve si mekanizëm për të siguruar mbrojtje dhe siguri në shkollë

Edhe pse konsiderojmë që Kosova është një vend i sigurt për të jetuar dhe për të vepruar, ku gjenë zbatim rendi dhe ligji, fatkeqësisht si në shumë vende demokratike edhe në Kosovë ndodhin situata ku njerëzit kanë këndvështrime të ndryshme dhe jo çdoherë pajtohen dhe i zgjidhin mospajtimet e tyre në mënyrë të drejtë të civilizuar dhe me dialog. Edhe në mesin e fëmijëve në veçanti moshat shkollore ballafaqohen me situata ku lindin mospajttime, kundërshtime dhe si pasojë vijnë deri tek konfliktet, të cilat sjellin probleme të ndryshme në mes bashkëmoshatarëve por edhe familjeve të tyre dhe mbarë shoqërisë.

Ndërtimi i një shoqërie demokratike është një sfidë për secilin shtet. Natyrisht, edukimi për respektimin e anëtarëve tjerë të shoqërisë, toleranca dhe mosdiskriminimi fillon që nga familja.

Në procesin e edukimit demokratik të individit dhe shoqërisë, rol të veçantë luan shkolla dhe aktivitetet socializuese në shkollë në mes të bashkëmoshatarëve dhe mësimdhënësve. Përveç njësive mësimore dhe kurrikulës shkollore që zbatohet përmes lëndëve të ndryshme në procesin mësimor, janë edhe një varg aktivitetesh që shkollat ndërmarrin

për të promovuar vlerat demokratike dhe arritjen e ideve dhe veprimeve në mënyrë koncensuale duke respektuar mendimin dhe nevojat e secilit.

Mbrojtja dhe sigurimi i mirëqenies së fëmijëve është përgjegjësi e të gjithëve; familjes, shkollës, institucioneve dhe komunitetit dhe duke pasur parasysh rolin dhe përgjegjësitë e secilit në këtë proces, mbrojtja dhe siguria e nxënësve duhet të jetë prioritet për secilin institucion arsimor dhe duhet të jetë në thelb të të gjitha proceseve dhe aktiviteteve të shkollës. Institucionet arsimore janë të obliguara të sigurojnë mekanizma që të mbrojnë nxënësit nga çfarëdo lloj dhune, përjashtimi social apo pasigurie që do ta dëmtonte mirëqenien e nxënësve.

Kjo obligon shkollat që të punojnë vazhdimisht në sigurimin dhe fuqizimin e mekanizmave që ngrisin vetëdijen por, edhe ndërmarrjen e veprimeve efikase për të adresuar dhe reaguar ndaj çdo forme të dhunës si dhe trajtimin e tyre në mënyrë të duhur dhe paqësore.

Për të siguruar mjedise të sigurta dhe miqësore për të gjithë në shkollë dhe për të ju përgjigjur situatave që mund të vijnë deri tek konfliktet në shkollë, Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë – MASHT ka hartuar disa rregullore dhe udhëzime administrative për parandalimin dhe referimin e dhunës. Zbatimi i tyre është përkrahur edhe me disa doracak si dhe manuale didaktike të cilat së bashku me trajnimet e shumta të ofruara për mësimdhënës dhe nxënës synon parandalimin, minimizimin dhe menaxhimin e rasteve të dhunës në shkolla dhe në shoqëri në përgjithësi.



“ Mbrojtja dhe sigurimi i mirëqenies së fëmijëve është përgjegjësi e të gjithëve; familjes, shkollës, institucioneve dhe komunitetit dhe duke pasur parasysh rolin dhe përgjegjësitë e secilit në këtë proces, mbrojtja dhe siguria e nxënësve duhet të jetë prioritet për secilin institucion arsimor dhe duhet të jetë në thelb të të gjitha proceseve dhe aktiviteteve të shkollës. ”

**Më poshtë gjeni të emërtuara rregulloret, udhëzimet, doracakët dhe manualët të cilat do t'i gjeni në aneks të këtij materiali si dhe linqet në internet.**

- Rregullorja e Qeverisë së Republikës së Kosovës (QRK)- nr. 21/2013 për Protokollin për parandalimin dhe referimin e dhunës në institucionet e arsimit para universitar.
- Udhëzuesi për zbatimin e Rregullores së QRK-nr. 21/2013 për protokollin për parandalimin dhe referimin e dhunës në institucionet e arsimit para universitar
- Doracaku për parandalimin e dukurive negative në shkollë të mesme të larta
- Doracak për ekipet ndërmyjetësuese mes bashkëmohatarëve
- Manual didaktik për parandalimin e dhunës

Bazuar në udhëzuesin për protokollin e parandalimit dhe referimit të dhunës në institucionet e arsimit

para-universitar, institucionet përgjegjëse duhet të zbatojnë kërkesat e protokollit të cilat merren me parandalimin dhe reagimin ndaj veprimeve të dhunshme në institucionet e arsimit para-universitar, siç klasifikohen të Protokollit në rrjete mbrojtëse:

- **Rrjeti i brendshëm mbrojtës:** Edukimi paras-hkollor – (Drejtori i Institucionit, Këshilli i Prindërve) dhe Shkollat (Drejtori i shkollës, Këshilli i Prindërve, Këshilli Drejtues i Shkollës dhe Këshilli i Nxënësve);
- **Rrjeti i jashtëm mbrojtës:** Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë - (Sektorët e Inspektimit të Arsimit në Rajon), Këshilli i Prindërve të Kosovës, Këshilli i Nxënësve në nivel nacional), Drejtoria Komunale e Arsimit- (Këshilli i Nxënësve dhe Këshilli i Prindërve në nivel komunal, Zyrtari përkatës për të Drejtat e Fëmijës), Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale - (Qendra për Punë Sociale, Qendrat e Mjekësisë Familjare, Ministria e Drejtësisë - (Shërbimi Sprovues i Kosovës, Shërbimi Korrektues i Kosovës, Policia e Kosovës si dhe Mekanizmat tjerë ndihmës - (Mediat, Institucioni i Avokatit të Popullit, organizatat joqeveritare që punojnë për të drejtat e fëmijëve dhe çështjet e dhunës në shkollë).

Këto dy rrjete të mbrojtjes janë të obliguara që të ndërmmarrin masa dhe veprime për të parandaluar çfarëdo situatë që sjell deri të shkelja e të drejtave të fëmijëve apo cenimi i mirëqenies së nxënësve.

Po ashtu manualët dhe doracakët ofrojnë shumë burime të cilat mund të inkorporohen si pjesë e plan programeve ku promovohen sjelljet dhe qëndrimet kundër dhunës dhe favorizohet zgjidhja paqësore e konflikteve që ju mundëson shkollave të krijojnë mjedise të pa dhunshme, klimë pozitive dhe konstruktive ndaj konflikteve.

Ndër të tjera manualët rekomandojnë ndërmarrjen e iniciativave edhe nga nxënësit dhe ndërmjetësimi mes bashkëmoshatarëve vlerësohet si metodë që kontribuon në zgjidhjen paqësore të konflikteve si dhe mundëson që nxënësit përmes bashkëbisedimit, diskutimit, ballafaqimit me konfliktet të arrijnë të zhvillojnë shkëlqimin e mira të komunikimit, të dëgjimit aktiv, mendimit kritik, vetëvlerësimit, zhvillimin e qëndrimeve pozitive ndaj konflikteve e respektimin e mendimeve dhe opinionëve të ndryshme.

## 2. Procesi i përkrahjes së shkollave në krijimin e mekanizmave brenda shkollave që promovojnë zgjidhjet paqësore të konflikteve

*Procesi i fillimit të zbatimit të projektit; hapat e ndërmarrë për të siguruar përkushtimin e shkollave në zbatim të aktivitetëve të planifikuara.*

Shkollat çdoherë kanë treguar gadishmëri që të ndërmarrin hapa në parandalimin e çfarëdo konflikti brenda shkolle apo jashtë saj kur nxënësit janë të përfshirë. Natyrisht që shkollat përveç detyrës primare që kanë në ofrimin e kushteve për mësimdhënie dhe zhvillimin e kapaciteteve intelektuale, fizike dhe socializuese të nxënësve duhet përkrahur edhe në iniciativat e ndërtimit të një ambienti demokratik dhe të tolerancës e mosdiskriminimit. Një ndër projektet që ka zgjuar shumë interesim, tashmë tek një numër i konsiderueshem i shkollave, është projekti **‘Promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të fëmijës’** projekt ky i implementuar nga KEC dhe forumZFD me financim nga EU.

Gjatë implementimit të këtij projekti në shumë shkolla anë e mbanë Kosovës është parë nevoja e një përkrahje të pakursyer nga ana e instancave komunale e në veçanti drejtorive komunale të arsimit të cilat identifikuan shkollat që të përfshihen në projekt dhe ndihmuan në realizimin e aktivitetëve duke ndihmuar shkollat me përkushtimin e tyre dhe përkrahjen me materiale organizative dhe didaktike.

Në veçanti kjo përkon edhe me synimet globale të Organizatës së Kombeve të Bashkuara – OKB, ndërlidhur me 17 Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm, të cilat konsistojnë në një platformë që synon transformimin e gjithë njerëzimit dhe planetit tonë në një rrugë të qëndrueshme zhvillimi brenda vitit 2030. Në veçanti do të veçonim: objektiva 4 për arsim cilësor; objektiva 5 për barazi gjinore; objektiva 10 zvogëlimi i pabarazive; objektiva 16 për paqe, drejtësi dhe institucione të qëndrueshme.



Kështu që fillimisht rekomandohet që nisma e projekteve të tilla të fillohet me prezente publike dhe të koordinohet me zyrtarët komunal, në mënyrë që mbarëvajtja e projektit të ketë edhe një njohje institucionale dhe një formë legjitimiteti. Gjithashtu koha dhe hapësira që i dedikohet aktivitetëve, të dokumentohet dhe vlerësohet si pjesë e procesit dhe planit të veprimit të shkollës. Vlen

të ceket se projekti ka nevojë dhe për përkrahje materiale (edhe pse minimale) sidoqoftë komuna dhe planifikimi buxhetor i drejtorive komunale të arsimit, do duhej të alokonin mjete për përkrahjen e projekteve dhe iniciativave të ndryshme të shkolave, për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, diversitetin dhe ndërtimin e shoqërisë demokratike.



Foto nga Sesiioni informues me shkollat

Pas miratimit dhe aprovimit nga niveli komunal hapi tjetër do duhej të jetë takimi me menaxhmentin e shkollës për të prezentuar projektin dhe përfitimet që sjell projekti tek nxënësit, mësime-dhënësit, prindërit, komuniteti si dhe kohëzgjatja dhe modalitetet e aktiviteteve.

Është e një rëndësie të veçantë që prezentimi i projektit të nxisë interesim tek menaxhmenti i shkollës dhe të fitohet një përkrahje e plotë për implementimin e projektit. Në të kundërtën projekti do të ketë vështirësi për implementim pasi që kërkohet një mobilizim i përgjithshëm i shkollës për të ndihmuar në mënyrë direkte apo indirekte në arritjen e objektivave të projektit.

### 3. Integrimi i planit vjetor të veprimit ndaj rasteve të dhunës dhe plani i ndërmjetësimit mes bashkëmoshatarëve në planin zhvillimor të shkollës

Bazuar në rregulloren QRK- nr. 21/2013 për të parandaluar dhe reaguar ndaj rasteve të dhunës, çdo institucioni arsimor i sugjerohet të zhvilloj planin vjetor të veprimit për parandalim të dhunës me bazë në shkollë si dhe pjesë e këtij plani të jetë edhe plani i aktiviteteve të ndërmjetësimit mes bashkëmoshatarëve.

Duhet të theksohet se secila shkollë në Kosovë është e obliguar të përpilojë Planin Zhvillimor të shkollës ku përcaktohen objektiva zhvillimore të shkollës. Sigurisht shkollat gjatë hartimit të Planit Zhvillimor fokus të veçantë duhet t'i kushtojnë aspektit të mbrojtjes dhe sigurisë në shkollë e cila duhet të planifikohet duke filluar nga analizimi i gjendjes, identifikimi i faktorëve që mund të sjellin situata të pasigurta dhe të pa mbrojtura për nxënësit dhe të tjerë si dhe të parashohin dhe vendosin objektiva konkrete dhe efektive për të parandaluar, adresuar dhe reaguar në situata të ndryshme. Ky planifikim i mirë do të mund të lehtësojë edhe bashkërendimin me objektivat dhe synimet e projekteve për të realizuar aktivitete të ndryshme duke përkruar me objektivat dhe veprimet e planifikuara në Planin Zhvillimor.



Në rastet kur shkolla nuk ka planifikuar objektiva që lidhen me mbrojtjen dhe sigurinë përkatësisht, fushën e kulturës dhe mjedisin shkollor kjo duhet diskutuar me menaxhmentin për të rishikuar dhe planifikuar objektiva dhe aktivitete të detajuara që do të ndërmerren nga shkolla por edhe në bashkëpunim me partnerët tjerë.

Krahas kësaj të përpilohet një plan-veprimi i detajuar për dinamikën dhe afatet kohore të implementimit të projektit, funksionalizmin e ekipeve të ndërmjetësimit, rolet, përgjegjësitë dhe afatet kohore.

## 4. Informimi dhe aktivizimi i palëve brenda shkollës në krijimin dhe fuqizimin e mekanizmave në shkollë

Pas marrjes së aprovimit dhe përkrahjes komunale për fillimin e projekteve në shkollat e selektuara; si dhe takimet fillestare me stafin menaxhues të shkollave të integruara në projekt, rekomandohet që hapat e ardhshëm të jenë: Debate inicuese me nxënësit dhe mësuesit të shkollës për projektin dhe problemin e ngacmimeve në shkollë si dhe aktivitete tjera që ndërlidhen me projektin dhe që kanë karakter informues dhe vetëdijësues për nxënësit si: format e komunikimit, raportet e shëndosha, rëndësia e negociatave, ndërmjetësimit, diversiteti dhe vlerat demokratike të integruara në shkollë, etj; aktivitete disa ditore që do të implementoheshin në javët e para të implementimit të projektit.

Përveç menaxhmentit të shkollës edhe nxënësit duhet të njihen gradualisht me projektin e ndërmjetësimit. Paraprakisht do duhej të realizoheshin një mori aktivitete të përgatitore, informuese për të debatuar dhe kuptuar më mirë me konceptet e ndërmjetësimit si dhe qasja e zgjidhjes paqësore të konflikteve.

Padyshim në këte fazë fillestare të projektit do ishte e këshillueshme edhe përfshirja e Këshillit drejtues të shkollës, duke përfshirë dhe prindërit dhe grupet tjera të interesit në komunitet. Për këtë qëllim do mund të mbaheshin disa sesioneve informuese dhe këshilluese për përmbajtjen dhe qëllimet e projektit si dhe nevojat

dhe përfitimet nga aktivitetet e ndërmjetësimit në mes të bashkëmoshatarëve. Gjithashtu për të evituar çfarëdo mbiveprim apo dyfishim të aktiviteteve do duhej që projekti i ndërmjetësimit të ndërlihet dhe të koordinohet edhe me aktivitete tjera në këtë fushë, brenda dhe jashtë shkollës, siç është edhe koordinimi me Ekipe shkollore për parandalim dhe reagim ndaj brakstisjes dhe mosregjistrimit në arsimin e obliguar-EPRMB.

Duke i zbatuar këto informata dhe njohuri do të mundësohet krijimi i kulturës mbështetëse në shkollë, ku të gjithë e posaqërisht nxënësit ndihen të sigurtë, të mbrojnë njëri-tjetrin, të dijnë të adresojnë brengat kur përballen me shkelje të drejtave të tyre, po edhe të nxisë përkushtimin e shkollës, prindërve dhe komunitetit lidhur me mbrojtjen e nxënësve.



## 5. Identifikimi dhe analizimi i gjendjes së shkollës në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë në shkollë

Para çdo aktiviteti apo projekti të filluar duhet që të njihemi me faktet, rrethanat dhe vëllimin e problematikës me të cilin projekti në fjalë do të merret. Gjithashtu është e dobishme të dihet edhe shkalla e njohurisë nga ana e nxënësve për çështjen me të cilën merret projekti (në këtë rast me konfliktet, natyrën e konflikteve dhe çasja e ndërmjetësimit në zgjidhjen e konflikteve).

Për të matur dhe përvetësuar njohuri paraprake që do të determinojnë ecurinë e implementimit të projektit, mund të zhvillohen disa instrumente në formë të pyetësorëve dhe anketave që mund të realizohen në shkollë dhe me pjesëmarrjen e vet nxënësve në përpillimin, administrimin dhe elaborimin e pyetësorëve të procesuar. Natyrisht, kjo mund të realizohet me ndihmën e mësimeve apo edhe të ndonjë prindi vullnetar që ka njohuri dhe shkathtësi në shkencat e fushës sociale.

Çështjet që mund t'i analizojmë përmes pyetësorëve dhe anketave mund të jenë mbi aspektet e përgjithshme të sigurisë në shkollë dhe perceptimit të nxënësve për faktorët që i brengosin ata dhe mendojnë që ju cenojnë sigurinë e tyre. Në mënyrë më specifike mund të analizohet problematika e ngacmimeve (p.sh. pyetësorë për njohurië mbi format dhe faktorët e ngacmimeve); aspektet e dhunës në shkollë; kërcënimet dhe forma tjera që cenojnë sigurinë e nxënësve në shkollë.




Të dhënat e dalura do të kontribuojnë në adaptimin më të mirë të intervenimeve të projektit në bazë të nevojave të shkollës si dhe ngjitjen e shkallës së vetëdijësisimit për këto dukuri, njëherit interesimin për identifikimin, parandalimin dhe trajtimin e këtyre dukurive negative në shkolla dhe në mesin e nxënësve.

## 6. Përzgjedhja dhe përcaktimi i nxënësve që do të përbëjnë ekipet e ndërmjetësisimit

Procesi i ndërmjetësisimit kërkon nga vet nxënësit që të ndërrmarin veprime në identifikimin e rasteve, ku individët apo grupe të nxënësve, janë në ndonjë konflikt dhe t'i zgjidhin ato në mënyrë të pavarur me një monitorim minimal nga ana e mësimit dhe menaxhmentit të shkollës. Siç kemi cekur më lartë është e një rëndësie të veçantë që shkollat të përfshihen në këtë projekt në mënyrë

vullnetare dhe të zotohen se do përkrahin në plotni implementimin e projektit. Në këtë kontekst është gjithashtu vendimtare dhe e pakontestueshme që nxënësit që do të përfshihen në grupet ndërmjetësuese të jenë gjithashtu të përfshirë në mënyrë të pavarur dhe vullnetare pa asnjë imponim të vetëm nga ana e askujt. Sepse një qasje e tillë e përfshirjes së nxënësve do të ndikojë në integritetin e tyre në procesin e ndërmjetësisimit, paanshmëri, besueshmëri dhe efikasitet.

Për të realizuar këtë parakusht në përzgjedhjen e nxënësve mund të sygjerohen mënyra të përshtatshme dhe objektive të përzgjedhjes së nxënësve. Për shkak të kompleksitetit të veprimeve në procesin e ndërmjetësisimit rekomandohet të përfshihen nxënësit e klasave më të larta se klasa e pestë deri në klasën e nëntë (V-IX). Pra një përzgjedhje nga të gjitha nivelet klasore. Gjithashtu, duhet të ketë një diversitet të nxënësve nga aspekti gjinor, etnicitetit (nëse shkolla ka etni të ndryshme), statusit socio-ekonomik të familjes si dhe arritjeve akademike në shkollë (pra jo vetëm nxënësit shembullorë dhe të 'privileguar'). Me rëndësi është të përfshihen jo vetëm nxënësit e dalluar por edhe nxënës që nuk janë shumë aktiv, më të ndrojtur, që vijnë nga situata të ndryshme jetësore, etj. Gjithashtu një segment i rëndësishëm i projektit janë edhe grupet përkrahëse, pra nxënës që nuk do të jenë direkt të përfshirë në procesin e ndërmjetësisimit por që do ndihmojnë këtë proces duke marr pjesë në informimin e nxënësve të tjerë për këtë aktivitet përmes fushatave të dizajnuara në shkollë, identifikimin e rasteve dhe referimin e tyre tek grupet ndërmjetësuese. Grupet mbështetëse mund të formohen edhe në klasët si paralele të ndara të shkollave më të mëdha sidomos në pjesët rurale.



Formimi i ekipeve të ndërmjetësimit duhet të formalizohet. Të caktohen rolet dhe përgjegjësitë e ekipeve të formuara. Të caktohet koha dhe mënyra e takimeve koordinuese dhe të përpiqet një plan veprimi.

## **7. Përgatitja dhe ngritja e kapaciteteve të nxënësve, mësimeve dhe akterëve tjerë për metodologjinë e ndërmjetësimit dhe zgjidhjes paqësore të konflikteve**

Projekti i ndërmjetësimit si aktivitet të veçantë dhe të detyrueshëm ka organizimin e sesioneve të trajnimit për ndërmjetësim si dhe të përgatitjen e nxënësve dhe një numri të stafit të shkollës, për

parimet e përgjithshme dhe teknikat e ndërmjetësimit në mes të nxënësve.

Trajnimet rekomandohet të përsëriten çdo vit dhe të përfshihen grupet e ndërmjetësimit në këto trajnime. Realizimi i trajnimeve dhe seminareve në fushën e të drejtave të fëmijëve, parandalimin e konflikteve ndihmon që mësimeve të reflektojnë në qëndrimet dhe perceptimet e tyre si dhe të zhvillojnë shkathtësi për menaxhimin e situatave të ndryshme. Trajnimi të ofrohet me trajner të çertifikuar, preferuar me përvojë paraprake në





ndërmjetësim dhe me metodologjinë e caktuar nga manuali i trajnimit. Këshillohet që të përfshihen diku 3-5% të nxënësve nga totali i numrit të nxënësve të shkollës. Çdo vit një numër i nxënësve përfundojnë shkollën dhe duhet që të plotësohen/ trajnohen me ndërmjetësues të rinjë. Edhe pse modeli i ndërmjetësimit bazohet në barazinë në mes të nxënësve një formë hierarkie horizontale e ndërmjetësuesve mund të vendoset në mënyrë që ndërmjetësuesit që kanë më shumë përvojë të përkrahin dhe përgatitin ndërmjetësuesit e rinjë.

Në trajnime sygjerohet të përfshihen mësimdhënësit, prindërit si dhe anëtarë të Këshillit drejtues të shkollës (apo anëtarë nga komuniteti përreth shkollës) me qëllim që të krijohet kulturë e punës së përbashkët për të adresuar dhe

“ Realizimi i trajnimeve dhe seminareve në fushën e të drejtave të fëmijëve, parandalimin e konflikteve ndihmon që mësimdhënësit të reflektojnë në qëndrimet dhe perceptimet e tyre si dhe të zhvillojnë shkathtësi për menaxhimin e situatave të ndryshme. ”

menaxhuar konfliktet nga vet shkolla, po ashtu të ngritet vetëdija e reagimit dhe raportimit sa i përket mbrojtjes dhe sigurisë në shkollë.

Organizimi i sesioneve këshilluese periodike me prindër dhe nxënës mund të ndikojë në rritjen e ndërgjegjësimit të të gjithë akterëve në shkollë.

## 8. Emërimi dhe certifikimi i nxënësve që përbëjnë ekipin për ndërmjetësim

Në fund të trajnimit është e rëndësishme që nxënësit të certifikohen për trajnimin me një ceremo-

ni formale të certifikimit si dhe të përcaktohet roli i tyre në shkollë duke patur kujdes që të mos cenohet integriteti i tyre dhe koha që dedikojnë për këtë aktivitet, të mos interferojë me procesin mësimor dhe aktivitetet tjera edukative obligative.



Po ashtu, përbërja e ekipit të ndërmjetësimi duhet të jetë e njohur për të gjithë pjesëtarët e shkollës, mund të vendoset si poster (letër informuese) që pasqyron se kush janë anëtarët e ekipit si dhe funksionin e tyre.



## 9. Krijimi i hapësirës/klasës brenda shkollës për aktivitetet e ndërmjetësimit dhe zgjidhjes paqësore të konflikteve

Duke u nisur nga procesi i edukimit, nxënësit nuk arrijnë të mësojnë dhe kuptojnë të drejtat e tyre në mjedise kur nuk respektohen dhe nuk promovohen këto të drejta, po ashtu nuk arrijnë të zhvillojnë shkathtësi komunikimi, negociimi, reflektimi kur ato nuk promovohen. Këto janë disa nga arsyet që shkollat sugjerohet të sigurojnë mjedise të mbrojtura, të sigurta dhe atraktive në shkollë ku nxënësit komunikojnë lirshëm për brengat e tyre, mbështesin njëri-tjetrin dhe mësojnë përvoja të reja.

Për të mundësuar punën efektive të ekipeve të ndërmjetësimit shkolla është e rëndësishme (dhe kjo duhet të diskutohet në fillim të projektit me menaxhmentin e shkollës) të caktojë një hapësirë/ klasë për punën e ekipit të ndërmjetësimit ku munden të takohen për të koordinuar aktivitetet e tyre dhe zhvillimin e sean-

cave të ndërmjetësimit. Sygjerohet që hapësira të jetë e përshtatshme, lehtë e qasshme, e identifikueshme, e pajisur me mjetet e materiale që promovojnë zgjidhjen paqësore të konflikteve, të mirëmbajtura si dhe të sigurohet konfidencialitet në zhvillimin e aktiviteteve.

Mbështetja më e rëndësishme që mund të japë një shkollë në këtë aspekt është të mundësojë kuptimin e të drejtave të fëmijëve, njohjen e situatave konfliktuoze, menaxhimin e ngacmimeve, konflikteve si dhe këshillimin mes bashkëmohatarëve duke krijuar këtë mjedis.

Hapësira/ klasa për procesin e ndërmjetësimit është një vend që duhet të kultivoj tek nxënësit vlera, qëndrime dhe njohuri të vazhdueshme për çmuarjen e diversitetit, pranimin dhe respektimin e të gjithëve. Krijimi i hapësirave të tilla dhe përdorimi i tyre me qëllim të bashkimit të nxënësve për të diskutuar aspekte të ndryshme që i preokupon, i bën të vetëdijshëm për vlerat demokratike, potencialet njerëzore dhe mundësitë e barabarta që i ndihmojnë secilit nxënë të zhvilloj tolerancën, vlerësimin dhe çmuarjen e përvojave të secilit individ.





*“Fëmijët që edukohen në një mjedis të tillë, do të jenë të aftë të zgjidhin problemet e të marrin vendime me efektivitet.”*

*(Dickson)*

Krijimi i hapësirës/klasës për ndërmjetësim mund të sjell sfida në menaxhimin e saj duke pasur parasysh që përfshin direkt dhe jo direkt shumë faktorë edukativ si nxënësit, mësuesit, menaxhuesit e shkollës, familjen dhe komunitetin.

Meqenëse të gjithë këta faktorë e kanë rëndësinë e pa diskutueshme nevojitet që të gjithë bashkë të njihen

me qëllimin dhe procesin e punës në këtë hapësirë/klasë por edhe për format e ndryshme që nevojiten për menaxhimin e saj që të siguroj mbrojtje, konfidencialitet dhe produktivitet për gjithë veprimtarinë e saj. Ky lloj diskutimi do të lehtëson përballimin e ndonjë sfide që mund të paraqitet dhe të vlerësohet si një vend i domosdoshëm dhe miqësor për të gjithë.



## 10. Dizajnimi dhe zhvillimi i fushatave vetëdijësuese në shkollë të udhëhequra nga nxënësit

Në kuadër të planit vjetor të veprimit ndaj rasteve të dhunës dhe planit të ndërmjetësimit duhet të definohen edhe iniciativat për të realizuar fushata informuese, vetëdijësuese dhe avokuese për palët e interesuara që mund të dizajnohen dhe udhëheqen nga nxënësit.

Aktivitetet vetëdijësuese dhe iniciativat avokuese të udhëhequra nga nxënësit janë mundësi e mirë të promovohen vlerat dhe sjelljet e shëndosha, identifikimi i formave të përshtatshme dhe paqësore për zgjidhje të situatave konfliktuozë, si dhe promovimin e vlerave demokratike dhe marrëdhinieve të shëndosha si në klasë, në shkollë, në rrugë, familje dhe shoqëri.

Përveq tjerash në kuadër të këtyre aktiviteteve mund të zhvillohen sesione këshilluese në mes nx-

ënësve dhe mësimdhënësve me tema të ndryshme që ju ofron mundësi nxënësve të përgatiten dhe zhvillojnë shkathtësi të mira avokimi për të dizajnuar fushata dhe iniciativa avokuese efektive me bazë në shkollë dhe komunitet.

### Disa nga temat që mund të trajtohen dhe zhvillohen në këto sesione këshilluese mund të jenë:

- komunikimi efektiv në situatë konfliktuozë;
- lidhja e të drejtave dhe përgjegjësive në jetën e përditshme,
- zhvillimi i ideve për mënyrën si të promovohen të drejtat e fëmijës,
- diskutimi i stereotipave gjinorë dhe i barazisë gjinore,
- promovimi i gjithëpërfshirjes, tolerancës, mos diskriminimit
- formulimi i mesazheve avokuese, e të tjera.

Për të realizuar nismat e tilla, shkollat sugjerohen të ofrojnë mundësi dhe t'i përkrahin të gjithë nxënësit pa dallim që të përfshihen në aktivitete të cilat fuqizojnë rolin e tyre në ngritjen e zërit për çështjet që i brengosin, demonstrimin e fuqisë së avokimit nga bashkëmoshatarët, adresimin e brengave të tyre tek mekanizmat kryesor, ngritjen e vetëdijës së nxënësve për të zgjidhur mosmarrëveshjet në mes vete nëpërmjet ndërmjetësimit formal dhe jo formal nga bashkëmoshatarët;

Këto iniciativa avokuese mund të prodhojnë shumë materiale promovuese të cilat mund të vendosen dhe shpërndahen në shkollë, komunitet dhe media me qëllim sensibilizimin e shoqërisë si dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve. Disa nga materialet promovuese mund të jenë: fletushka, broshura, postera, pllakata, video mesazhe e të tjera.

## **11. Përshirja dhe angazhimi i prindërve dhe komunitetit për të kontribuar në aktivitetet e shkollës**

Shkolla dhe familja janë dy sisteme të ndërlidhura dhe se bashkëpunimi reciprok sjell shumë përfitime si tek fëmijët, mësimmshënësist dhe shoqëria. Megjithatë, roli dhe funksioni i shkollës është të ndihmojë familjen të përmbushë përgjegjësitë e saj dhe të kontribuojë në zhvillimin e fëmijëve por edhe nxitjen e prindërve për tu angazhuar në aktivitete të shkollës që ndikojnë në pasurimin dhe avansimin e cilësisë së procesit mësimor por edhe të aspekteve tjera që e përbëjnë atë.

Partneriteti i mirëfilltë mes shkollës dhe prindërve arrihet kur përshirja e prindërve është diverse, gjithëpërfshirëse dhe përfaqëson të gjithë nxënësist pa dallim dhe vë në pah nevojat dhe kërkesat e nxënësve si dhe ndërmerren veprime konkrete për të ndryshuar klimën dhe mjedisin në shkollë në intersin më të mirë të nxënësve dhe të gjithë pjesëtarëve të saj.

Ekzistojnë argumente dhe hulumtime të ndryshme që tregojnë se fëmijët kanë më shumë sukses nëse ekziston një partneritet i mirëfilltë në mes prindërve dhe shkollës. Përfshirja e prindërve dhe marrëdhënia e tyre me shkollën është shumë e rëndësishme dhe mund të ndikojë në përmirësimin e rezultateve mësimore të nxënësve, nxitjen e bashkëpunimit mes nxënësve, socializmin e nxënësve dhe prindërve, pranimin e diversiteteve, forcimin e marrëdhënies, inkurajimin e sjelljeve dhe veprimeve të shëndosha, ofrimin e mundësive për të mësuar dhe shkëmbyer përvoja nga perspektiva të ndryshme që prindërit mund të sjellin në shkollë.

Nëse nxënësist përjetojnë vështirësi në shkollë është shumë e rëndësishme që të zhvillohen komunikimet e mira me prindërit dhe personat e tjerë kyçë për të kontribuar në tejkalimin dhe menaxhimin e situatave kur ata sfidohen. Kjo rezulton me vendosje të marrëdhënies të mira edhe mes nxënësve, prindërve dhe shkollës.

Informimi i prindërve për pjesëmarrje në këto aktivitete mund të bëhet përmes takimeve formale apo seshioneve konsultuese për rëndësinë dhe rolin e tyre në angazhimin që mund të japin për aktivitetet e shkollës e në veçanti për kontributin e tyre në sigurimin e mjedisve mbështetëse dhe të sigurta për fëmijë.

Prindërit duhet të jenë të informuar për të gjitha ndryshimet që ndodhin në shkollë dhe në jetën e fëmijëve të tyre dhe për këtë kanë nevojë të përkrahen për të zhvilluar shkathtësitë e reja të bashkëpunimit, komunikimit dhe zhvillimit të pjesëmarrjes së familjes në këto aktivitete.

“ Nëse nxënësit përjetojnë vështirësi në shkollë është shumë e rëndësishme që të zhvillohen komunikimet e mira me prindërit dhe personat e tjerë kyçë për të kontribuar në tejkalimin dhe menaxhimin e situatave kur ata sfidohen. ”

Në veçanti shkolla mund të angazhojë prindërit profesionist me profile nga mirëqenia sociale, shëndetësia, arsimit, përmes organizimit të ligjëratave dhe sesione me debateve duke shtuar informacionin të nxënësit dhe pjesëtarët e shkollës mbi efektet dhe pasojat e dhunës. Po ashtu prindërit mund të angazhohen në punë vullnetare në ngjarje dhe aktivitete vetëdijësuese, sesione këshilluese, krijimin e materialeve promovuese e të tjera.

Po ashtu shkolla duhet të trajtojë dhe adresojë brengat e nxënësve, ngacmimet, çështjet e dhunës brenda dhe përreth shkollës, duke pasur parasysh të gjitha relacionet nxënës-nxënës, mësimsdhënës-nxënës e anasjelltas, mësimsdhënës-mësimsdhënës, mësimsdhënës-prindër e anasjelltas, udhëheqës-mësimsdhënës e anasjelltas në takimet me prindër, këshillin drejtues të shkollës, këshillin e nxënësve si dhe me organet tjera që e përbëjnë shkollën duke përfshirë edhe pjesëtarë të komunitetit rreth shkollës.

## 12. Sigurimi i qëndrueshmërisë së mekanizmave të krijuar brenda shkollës

Aktivitetet fillestare të ndërmjetësimit nuk kërkojnë fonde të mëdha dhe mund të zhvillohen kryesisht në mënyrë vullnetare dhe në bazë të kushteve që ka shkolla, mirëpo mund të krijohen mundësi që për aktivitete të caktuara të sigurohen fonde që ndikojnë në pasurimin dhe avansimin e mekanizmave mbrojtës në shkollë. Një fond i vogël për këtë qëllim mund të formohet dhe të menaxhohet me transparencë nga vet shkolla.

## 13. Burimet e nevojshme për të zhvilluar aktivitetet e ndërmjetësimit dhe krijimit të kulturës për zgjidhje paqësore të konflikteve në shkollë

Aktivitetet e ndryshme kërkojnë sigurim të burimeve të ndryshme për mbarëvajtjen e projektit. Përveç materialeve, mjeteve dhe paisjeve bazike të nevojshme të punës, shumë nga burimet e nevojshme janë të domosdoshme për funksionimin e mekanizmave që ndikojnë në zhvillimin dhe ruajtjen e kulturës së shkollës.

Për të zhvilluar aktivitete atraktive dhe efektive në fushën e mbrojtjes së fëmijëve dhe funksionin efikas të punës së ekipit të ndërmjetësimit nevojitet sigurimi i paisjeve elektronike, qasja e mbrojtur në

internet, pasurimi i hapësirës/klasës së ndërmjetësimit me literaturë përkatëse si broshura, doracakë, video mesazhe si dhe përkrahje teknike nga mësimdhënësit që kanë njohuri në teknologji informative për dizajnimin dhe prodhimin e materialeve të ndryshme që kontribuojnë në pasurimin dhe avansimin e mekanizmave dhe praktikave të mira në shkollë.

Po ashtu materialet promovuese mund të përdoren si burime informimi për prindër dhe mësimdhënës në drejtim të mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të fëmijëve, të cilat mund të jenë si: linqe/vegëza, blog, informatorë, mësim model, aktiviteteve praktike si dhe materiale tjera përfshirë filma vizatimorë, video edukative me lojëra elektronike për fëmijë.

## **14. Promovimi i qasjes së zgjidhjes paqësore të konflikteve- Aktivitete alternative- jashtë kurrikulare për të sensibilizuar dhe aktivizuar nxënësit në shkollë**

Mosëmarrëveshjet, grindjet e konfliktet janë pjesë e natyrshme dhe e pashmangshme e jetës në përgjithësi e po ashtu edhe e proceseve arsimore. Shpesh një situatë konfliktuozë mes nxënësve mund të vie si pasojë e mendimeve apo opinioneve ndryshme, qëndrimeve dhe veprimeve jo të drejta ndaj individëve apo grupeve e që mund të sjellin tek grindjet e konfliktet mes tyre në forma të ndryshme.

Megjithatë, këto situata mund të trajtohen me çasje konstruktive që mund të determinon edhe zgjidhjen paqësore të konflikteve. Sigurisht që mësimdhënësit, prindërit dhe të tjerë mund të punojnë me nxënësit për të zhvilluar tek ta shkathtësi dhe mënyra të trajtimit dhe zgjidhjes së konflikteve në mënyrë paqësore.

Zhvillimi i aktiviteteve edukative dhe sociale që trajton konfliktet por edhe përfshinë të gjithë pjesëtarët e shkollës në reflektim dhe diskutim për situata të tilla kontribuon në krijimin e parakushteve për të pranuar konfliktet si mundësi për mësuar dhe zhvilluar aftësi dhe shkathtësi ndërpersonale dhe sociale. Trajtimi dhe diskutimi për konfliktet në mënyrë konstruktive rrit tek nxënësit ndjenjën e përgjegjësisë, sigurisë dhe llogaridhënies.


Aktivitetet jashtë-kurrikulare duhet të konsiderohen si një pjesë e rëndësishme e përfshirjes sociale por edhe aktivizimit të të gjithë nxënësve pa dallim për të qenë përfitues dhe pjesëmarrës aktiv në këto aktivitete.

Aktivitetet jashtë kurrikulare të udhëhequra nga nxënësit ndërmjetësues dhe përkrahës mund të zhvillohen me metodologji të ndryshme pune, si: ligjërata, debate, aktivitete artistike me temë kundër dhunës; me raste të imagjinuara (simulimi i rasteve fiktive); lojës me role, dramatizimit, lojëra sociale, aktivitete garuese, shfaqje teatrale, ekspozitat me punime artistike e të tjera. Po ashtu, mund të realizohen edhe aktivitete vetëdijësuese të llojllojshme në bashkëpunim me organizatat joqeveritare.





## **PJESA II**



## **AKTIVITETET E NDËRMARRA NGA SHKOLLAT PËR TË PROMOVUAR ZGJIDHJEN PAQËSORE TË KONFLIKTEVE- NDËRMJETËSIMI MES BASHKËMOSHATARËVE**

Aktivitetet që janë zhvilluar në shkolla si praktika të mira nga to janë realizuar shfaqje teatrale si pjesë e fushatës vetdijësuese, metoda tjera kreative të trajnimeve dhe aktiviteteve që promovojnë komunikimin, diversitetin dhe ndihmën e ndërsjelltë. P.sh. aktiviteti “Imagjino një ditë”, aktiviteti i nxënësve në dy grupe me sjellje të mira dhe jo të mira; debat pas një aktiviteti të tillë, e të tjera.

Më poshtë janë dhënë shembuj të aktiviteteve dhe iniciativave të ndryshme të cilat janë zhvilluar në shkolla të ndryshme dhe që kanë promovuar dhe trajtuar të drejtat e fëmijëve si dhe aspektet e shfaqjes së dhunës si dhe menaxhimin paqësor të tyre përmes metodave dhe formave të ndryshme.

- Promovimi i qasjes së zgjidhjeve paqësore të konflikteve përmes artit, lojës me role, dramatisimit dhe debateve
- Realizimi i ekspozitave artistike mbi temën „Dhuna në shkollë, pasojat dhe si t’i zgjidhim konfliktet“
- Realizimi i aktiviteteve të orëve letrare me po të njejtën temë: „Dhuna në shkollë, pasojat dhe si t’i zgjidhim konfliktet“
- Përpilimi i pllakatave, broshurave, fletëpalosjeve, debateve dhe forma tjera të informimit për nxënësit dhe ndërmjetësimin (përpiluar nga vet nxënësit, me ndihmë minimale nga mësuesit)
- Përpilimi i llogos për grupet e ndërmjetësimit, identifikimi me ngjyra të përzgjedhura, bluzave, kapelave apo shenjave tjera identifikuese për ndërmjetësimin.

# PRAKTIKAT E MIRA TË REALIZUARA NË SHKOLLA DHE TË PËRKRAHURA NGA OJQ-të

## 1. OJQ- EDUCATION COMES FIRST

Organizata Education Comes First është themeluar me qëllimin që të ofroj programe bashkëkohore dhe kreative në fushën e edukimit, për të ndihmuar dhe avansuar fëmijët dhe adoleshentët. Vepron në Komunën e Gjakovës.



### Shkollat partnere me të cilat kanë realizuar aktivitetet:

- 1** SHFMU „Zef Lush Marku“ në Brekoc, Komuna e Gjakovës
- 2** SHFMU „Ukshin Miftari“ në Skivjan, Komuna e Gjakovës
- 3** SHFMU „Gjergj Fishta“ në Bishtazhin, Komuna e Gjakovës
- 4** SHFMU „Anton Çeta“ në Dol, Komuna e Gjakovës

## Aktivitetet e zhvilluara:

- Krijimi i blogut për të drejtat e fëmijëve;
- Thirrja për nxënësit: “Ese dhe video për të drejtat e fëmijëve”
- Promovimi i blogut në shkolla;
- Promovimi i blogut në media/rrjete sociale;
- “Një Botë pa konflikt” për nxënësit e kl.I- IV, të mësuarit përmes fotove;
- “E drejta ime të jetoj pa dhunë” për nxënësit e kl. V- IX, krijimi i fotove që prezantojnë të drejtat e tyre të jetojnë të lirë dhe në paqe;
- Përzgjedhja e fotove dhe prezantimi i tyre në Ditën Ndërkombëtare për të drejtat e fëmijëve;
- Organizimi i konferencës për media në Ditën Ndërkombëtare për të drejtat e fëmijëve;
- Shpërndarja e materialeve promovuese për të drejtat, përgjegjësitë dhe mbrojtjen e fëmijëve;
- Organizimi i tryezës së rrumbullakët.

## REZULTATET NGA AKTIVITETET E REALIZUARA:



Nxënësit janë argëtuar dhe kanë shfaqur interesim për tu përfshirë, duke bërë që secili të merr pjesë në aktivitet. Nxitja e debatit dhe diskutimi duke mësuar për të drejtat e fëmijëve, përmes këtyre aktiviteteve është nxitur të menduarit kreativ dhe nxitja e imagjinatës.



Aktivitetet u zhvilluan në shkolla, ku janë prezentuar foto të fëmijëve në vende të ndryshme të botës që ilustrojnë të drejtat e tyre dhe zhvillimi i imagjinatës së fëmijëve për të jetuar në një botë në paqe dhe pa dhunë. Fëmijët nëpërmjet lojës kanë eksploruar fotografitë, duke i gjetur dy të njëjta dhe kështu është mundësuar të mësojnë për të drejtat e tyre dhe të diskutojnë.

## 2. AGJENSIONI PËR SHËRBIME SOCIAL EDUKATIVE OJQ “SHPRESA E JETËS”

Agjensioni për shërbime social edukative OJQ “Shpresa e Jetës” është organizatë jofitimprurëse, për të ndihmuar në rikonstruktimin e shoqërisë civile të dalë nga lufta. Misioni i saj është promovimi i dinjitetit njerëzor përmes zhvillimit dhe bashkëpunimit me theks të veçantë në fushën sociale dhe të edukimit dhe të promovimit dhe mbrojtjen e drejtave të fëmijës. Selia gjendet në Prishtinë dhe vepron në tërë Kosovën.

### Shkollat partnere me të cilat kanë realizuar aktivitetet:

- 1 SHFMU “Dom Mikel Tarabulluzi” Stubëll, Komuna Viti
- 2 SHFMU “Ahmet Rrustemi” Bec, Komuna Gjakovë
- 3 SHFMU “Avni Rrustemi” Zallq, Komuna Istog
- 4 SHFMU “Rilindja” Trestenik, Komuna Pejë



## Aktivitetet e zhvilluara:

- Pyetësorët për matjen e njohurive për ngucakeqësinë në shkollat partnere
- Takimi me mësimdhënësit e katër shkollave të përzgjedhura me Projekt – Punëtori e Përbashkët;
- Takimet me Nxënësit bashkëmohatar, shtjellimi i temave të ndryshme.
- Takimet me prindër dhe arsimtarë, ballafaqimi i tyre me ngucakeqësin tek fëmijët e tyre
- Tryezë pune me përfaqësuesit e Drejtorive Arsimore të Komunave në të cilat realizohet projekti dhe drejtorëve të shkollave të përzgjedhura me projekt; prezantimi i raportit të hulumtimit të dy fazave mbi efektin e programit „Për një shkollë miqësore“ me katër shkollat fillore të Kosovës

## REZULTATET NGA AKTIVITETET E REALIZUARA:

Edhe pse shumica e nxënësve në fillim të plotësimin të pyetësorit kanë deklaruar se ata nuk janë të përfshirë në asnjë formë të ngacmimit, por pyetjet e mëtejshme kanë gjetur se shumica e nxënësve është ngacmuar së paku njëherë në shkollë gjatë muajve të fundit.



Pas programit, nxënësit kanë raportuar një nivel më të ulët të viktimizimit nga ngacmimi në shkollë (nga 70.89% në 51.85%). Gjithashtu, një numër i konsideruar nxënësish kanë raportuar zgjidhjen e problemit të tyre pas pjesëmarrjes në program (nga 78.81% në 83.93% në shkollë dhe nga 64.08% në 75.61%).



Pas ndërhyrjes me aktivitetet e programit, nxënësit kanë treguar përkushtim për të zgjidhur problemet e ngacmimit, para së gjithash me forcat e tyre, nëpërmjet mënyrave paqësore. Në rast të dështimit, nxënësit kanë shfaqur nevojën për të raportuar problemet tek mësimdhënësit e tyre dhe autoritetet e tjera përkatëse.

(Para se të ndjekin programin, shumica e nxënësve e kanë theksuar raportin tek mësuesi i tyre si një formë primare për zgjidhjen e problemeve të tyre.)



Në të dy fazat e hulumtimit, nxënësit kanë parë të nevojshme që të kenë një psikolog të shkollës. Shumica e nxënësve deklaruan se do të konsultoheshin personalisht me psikologun e shkollës.

- Pas programit, nxënësit kanë qenë më të shkathët të përballen me dhunën në shkollë (nga 5.45 në 6.32, nga 1-10) dhe në internet (nga 5.92 në 6.96, nga 1-10)
- Pas implementimit të projektit në tërësi dhe ofrimit të klubeve të ndërmjetësimit disa nga shkollat kanë marr iniciativë që të aktivizojnë klubin e ndërmjetësimit për të qenë më efikas, duke përgatitur maica për ndërmjetësuesit në mënyrë që ata të identifikohen në shkollë, një iniciativë shumë e mirë, pastaj në këndet e tyre kanë vendos thënie të ndryshme për drejtat e fëmijëve, etj.

### 3. QENDRA PËR DRAMË DHE AKTIVITETE KREATIVE PËR FËMIJË DHE TË RINJË „QESHU – SMILE“, PRISHTINË

Qendra për dramë dhe aktivitete kreative për fëmijë dhe të rinjë „Qeshu – Smile“, Prishtinë është OJQ e cila aktivitetin e vet e zhvillon që nga viti 2000. Aktivitetet kryesore të „Qeshu – Smile“ janë edukative, psiko-sociale dhe kulturore. Sistemi kryesor i mënyrës së realizimit të projekteve të „Qeshu – Smile“ është mënyra interaktive.



#### Shkollat partnere me të cilat kanë realizuar aktivitetet:

- 1 SHFMU „Afrim Gashi“ – Hajvali, Prishtinë
- 2 SHFMU „Shkëndija“ – Hajvali, Prishtinë
- 3 SHFMU „Zejnel Salihu“ – Bardh i Madh, Fushë Kosovë
- 4 SHFMU „Laura Scotti“ – Graboc i Poshtëm, Fushë Kosovë

## Aktivitetet e zhvilluara:

- Realizimi i anketimit nëpër shkolla për të marrë parasysh interesimin dhe dëshirat e fëmijëve rreth temave të filmave, realizuam anketimin me fëmijë në mënyrë që të kemi një pasqyrë më objektive. Pyetësoni për anketim u formulua nga vetë grupi i nxënësve pjesëmarrës të drejtpërdrejt, ku ata përcaktuan të drejtat që sipas tyre janë më të atakuara. Ky veprim u realizua në të katër shkollat. Me pyetësonin e formuluar në këtë mënyrë realizuam anketimin nga i cili nxorrëm katër tema që sipas rezultateve ishin më të atakuara, e në bazë të këtyre temave kemi realizuar skenarët e më pastaj filmat.
- Trajnimi për stopmotion animacion - Stopmotion është një teknikë kreative e realizimit të filmave të animuar. Arsyeja që na shtyri të përdorim këtë metodë për realizimin e filmave dhe përmes kësaj promovimin e të drejtave të fëmijës është fakti që në këtë metodë fëmijët drejtpërdrejt janë pjesëmarrës të realizimit të filmave nëpër të gjitha fazat e realizimit të filmave. Stopmotion është një teknikë që u ndihmon atyre që e mësojnë këtë të trajtojnë dhe shprehin idetë e tyre edhe në të ardhmën përmes kësaj metode kreative, pra jo vetëm të trajtimit të të drejtave të fëmijës por edhe çështjeve tjera që ata i preokupojnë.
- Debatimet duke u bazuar në filmat e animuar – nxitja e debatit përmes filmave është një metodë spontane e kyçjes së pjesëmarrësve, në debat sa më të sinqertë. Siç dihet shpesh metodat klasike të organizimit të debateve në të shumtën e rasteve janë shëndrruar në stereotipe dhe nuk japin rezultatet reale mbi një çështje dhe gjithashtu mungon sinqeriteti në përgjigje. Shpesh pjesëmarrësit ngurrojnë të shprehën por edhe kur shprehën, janë pothuajse brenda kornizave të instruara të shprehjes. Metoda që kemi përdorur në ka ndihmuar që pjesëmarrësit të nxitur nga filmi, janë bërë pjesë aktive e debatit, i cili ka rezultuar shumë më i sinqertë sepse ata pahetueshëm janë bërë pjesë reale e debatit dhe gjithashtu kjo metodë nuk lejon pyetje të konstruktura ashtu që paraprakisht t'u dihen përgjigjet. Promovimi i të drejtave të fëmijës përmes kësaj metode është bërë shumë efektiv.
- Projekti „Ngjyrat“ ka qenë projekt i bazuar drejtpërdrejt në promovimin e të drejtave të fëmijës dhe se kjo metodë kreative e realizimit të filmave ju mundëson nxënësve të krijojnë shkathësi komunikative që do të përdoren në rastet e ndërmyjetësimit.
- Po ashtu, gjatë zhvillimit të aktivitetit janë krijuar dhe trajnuar grupet e fëmijëve për secilën disiplinë:
  - grupi i skenarit,
  - grupi i krijimit të skenografisë,
  - grupi i krijimit të karaktereve,
  - grupi i huazuesve të zërit,
  - grupi i krijimit të storyboardit
  - grupi i realizimit të animacionit, etj.



Ajo që i unifikonte këto grupe ishte qëllimi i përbashkët i krijimit të filmit përmes të cilit do të trajtonin temën e caktuar të të drejtave të fëmijës.

Gjatë këtyre aktiviteteve është nxitur bashkëveprimi – interaktiviteti si në gjetjen e formave më efektive të realizimit poashtu edhe në aspektin e zhvillimit të komunikimit verbal që besojmë se do t'u ndihmojë në të ardhmën edhe në procesin e ndërmjetësimit dhe zgjidhjes së çështjeve. Komunikimi zhvillohej mes grupeve të caktuara gjatë procesit të trajnimit, p.sh. grupi i krijimit të karaktereve me grupin e huazuesve të zërit apo me ata të realizimit të skenarit.

### REZULTATET NGA AKTIVITETET E REALIZUARA:



Nxënësit kanë mësuar të krijojnë film të animuar e përmes kësaj t'i trajtojnë temat që ata i preokupojnë.



Krijuam katër filma të animuar



Aftësimi për përdorimin e kësaj metode edhe në të ardhmën, jo vetëm për trajtimin e të drejtave të fëmijëve por edhe për çështje tjera.



Metodë keative, spontane dhe shumë efektive për zhvillimin e aftësive ndërmjetësuese.

## 4. QENDRA PËR STUDIME TË AVANCUARA FIT

Qendra për Studime të Avancuara FIT, e themeluar në Prishtinë. Objektivat primare të Qendrës FIT të identifikuar në fillimet e operimit të saj në shoqërinë kosovare janë: kontribimi në fushën e edukimit me qëllim të ngritjes së vetëdijes për zhvillimet më të rëndësishme politike, sociale dhe ekonomike në vend dhe përmirësimi i situatës sociale të grupeve me të cilat punon gjatë implemmentimit të projekteve.

### Shkollat partnere me të cilat kanë realizuar aktivitetet:

- 1 SHFMU "Teuta" në fshatin Grashticë, Komuna e Prishtinës
- 2 SHFMU "Avni Rustemi" në fshatin Mramor, Komuna e Prishtinës
- 3 SHFMU "Anton Zako Çajupi" në fshatin Bardhosh, Komuna e Prishtinës
- 4 SHFMU "Ganimete Tërbeshi" në fshatin Llukar, Komuna e Prishtinës



### Aktivitetet e zhvilluara:

- Fushata vetëdijësuese të cilat për synim kanë pasur ngritjen e vetëdijes për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.
- Hartimi i planit të veprimit të shkollës për ndërmjetësim mes bashkëmoshatarëve dhe zgjidhjen paqësore të konflikteve.
- Krijimi i Klubeve të Ndërmjetësimit brenda secilës shkollë partnere
- Krijimi një hapësire brenda shkollës që është e dedikuar për ndërmjetësim në mes bashkëmoshatarëve.
- Monitorimi dhe vlerësimi i vazhdueshëm i Klubeve të Ndërmjetësimit
- Ligjërata në shkollë për dhunën nëpërmjet internetit
- Ligjërata “Vullnetarizmi dhe benefitet e tij“

### REZULTATET NGA AKTIVITETET E REALIZUARA:



Qendra FIT ka bërë themelimin e katër (4) Klubeve të Ndërmjetësimit brenda secilës shkollë partnere. Nxënësit që janë pjesë e Klubeve të Ndërmjetësimit kanë marrë pjesë në trajnimin që është mbajtur në muajin prill 2018 ku ata janë trajnuar se si të bëhen ndërmjetësues të suksesshëm. Pas themelimit të Klubeve të Ndërmjetësimit, nxënësit trajner kanë trajnuar edhe nxënës të tjerë në shkollat e tyre për të përhapur njohuritë e tyre dhe zgjeruar klubet me anëtarë të rinjë. Klubet e Ndërmjetësimit kanë qenë të hapura për nxënësit që kanë dëshiruar të jenë pjesë e klubeve. Qendra FIT në vazhdimësi ka ndihmuar klubet e ndërmjetësimit dhe në baza mujore ka monitoruar dhe vlerësuar punën e tyre në ndërmjetësim të konflikteve të shkolla.



Hartimi i planit të veprimit të shkollës për ndërmjetësim mes bashkëmoshatarëve dhe zgjidhjen paqësore të konflikteve. Hartimi i

këtij plani është bërë nga grupi punues i cili përfshinë: ekspertin të cilin e ka angazhuar Qendra FIT, drejtorët e shkollave, dhe nga dy (2) mësimdhënësve dhe pesë (5) nxënësve në secilën shkollë.



Shkollat pëfituese kanë krijuar hapësira brenda tyre që janë të dedikuara për ndërmjetësim në mes bashkëmoshatarëve. Në memorandumet e bashkëpunimit që Qendra FIT i ka nënshkruar me shkollat parntere ishte paraparë që brenda shkollës të ketë një hapësirë e cila do të shfrytëzohet për ndërmjetësim në mes të bashkëmoshatarëve. Qendra FIT ka dizajnuar, shtypur dhe shpërndarë postera të mëdhenjë që kanë simbol gjirafën, pasi që ajo konsiderohet si kafsha e cila e ka zemrën më të madhe dhe që i sheh situatat nga një këndvështrim më i gjerë se të tjerët, tipare të cilat duhet t'i kenë nxënësitë që janë pjesë e ndërmjetësimit.

## 5. OJQ “MUNDËSIA” – MITROVICË

OJQ “Mundësia” bazohet në qasje të barabartë dhe zhvillim përfshirës, në mënyrë që të gjithë qytetarët mund të ushtrojnë të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre si pjesëtarë të plotë dhe aktiv të një shoqërie demokratike dhe shumë-etnike. Misioni i organizatës është të kontribuojë në zhvillimin e shoqërisë përmes fuqizimit të grupeve më të pafavorshme, në mënyrë që ato të mund të ushtrojnë plotësisht të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre, dhe mund të punojnë në mënyrë efektive drejt përmirësimit të pozitës së tyre shoqërore-ekonomike.

### Shkollat partnere me të cilat kanë realizuar aktivitetet:

- 1 SHFMU “Jusuf Rexha” Koshtovë, Komuna e Mitrovicës
- 2 SHFMU “Mehë Uka” – Fshati Bajgorë, Komuna e Mitrovicës
- 3 SHMFU “Shaban Idrizi” –Fshati Zhabar , Komuna e Mitrovicës
- 4 SHFMU “Harun Beka” – Fshati Gushavc, Komuna e Mitrovicës



### Aktivitetet e realizuara:

- Organizimi i performancave inter-aktive “Stop and Act Show” në baza 3 mujore me praktika të reja të zgjidhjes së konflikteve mes bashkëmoshatarëve dhe komunitetit në shkollat e synuara.
- Përkrahja në emërimin e tre personave nga personeli shkollor/anëtarëve të stafit në secilën shkollë - që do të avokojnë për të Drejtat e Fëmijëve dhe raportimin e dhunës.
- Organizimi i garës për Ese në 4 shkollat e projektit me temën për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës.
- Përkrahje në caktimin e “Personit të Besueshëm” në secilën shkollë të projektit për të raportuar dhunën.
- Organizimi i takimeve tremujore me mësuesit/arsimtarët për të parë ndryshimin e qëndrimeve dhe sjelljeve të fëmijëve/nxënësve në zgjidhjen paqësore të konflikteve.
- Shtypi dhe shpërndarja e materialeve promovuese të projektit nëpër shkollat e projektit.
- Organizimi i ngjarjes publike me rastin e fillimit të projektit dhe nënshkrimi i Memorandumeve të Mirëkuptimit në mes projektit dhe 4 Shkollave të synuara si dhe Drejtorinë e Arsimit, për realizimin e aktiviteteve.
- Organizimi i punëtorisë për shkollat e projektit në hartimin e planeve të veprimit të shkollës për ndërmjetësim mes bashkëmoshatarëve, mbrojtjen e fëmijëve dhe zgjidhjen paqësore të konflikteve
- Organizimi i 2 debateve/tryezave të rrumbullakëta për bashkëpunimin dhe koordinimin efektiv midis aktorëve lokalë (Drejtoria e Arsimit në Mitrovicë, Policia e Kosovës, Qendra për Punës Sociale, Ekipe të Sigurisë në Bashkësi, Mediat dhe OJQ-të që merren me qështjet e sigurisë dhe fëmijëve) dhe shkollave të projektit, në lidhje me të drejtat e fëmijëve dhe çështjet e mbrojtjes së fëmijëve
- Organizimi i ngjarjes publike për publikimin e të dalurave të projektit, rezultatet dhe rekomandimet.

### REZULTATET NGA AKTIVITETET E REALIZUARA:



Organizimi i performancave interaktive “Stop and Act Show” në baza 3 mujore me praktika të reja të zgjidhjes së konflikteve mes bashkëmoshatarëve dhe komunitetit në shkollat e synuara. Ky aktivitet është organizuar në bashkëpunim me një grup aktorësh/amator, të rinj nga Mitrovica, të cilët kanë përgatitur dhe shfaqur së pari një shfaqje të shkurtër që për temë kishte

dhunën në mes bashkëmoshatarëve, dhunën e arsimtareve ndaj nxënësve, si dhe temën e zgjidhjes së konflikteve në mes moshatarëve përmes ndërmjetësim-it. Kjo metodë është treguar si metodë mjaft efikase në kuptimin e nxitjes së nxënësve që të flasin më lirshëm si dhe të ketë debat të hapur dhe konstruktiv, si dhe

gjetjen e mënyrës se si të zgjidhet një problem i parashtruar përmes shfaqjes interaktive.

Nxënësit dhe personeli shkollor kanë vlerësuar se kjo mënyrë e paraqitjes së „problemeve“ përmes teatrit si dhe involvimi i publikut/nxënësve dhe interaktiviteti i tyre në mënyrën se si të zgjidhet ky problem ishte diçka e re dhe atraktive dhe e mirëpritur nga nxënësit.

Disa nxënësit e shkollave kanë treguar interesimin që ata vet të vazhdojnë me këtë lloj aktiviteti, pra përmes shfaqjeve interaktive të shtjellojnë edhe tema tjera në shkollën e tyre.

Gjithashtu trajnimet e ndërmjetësimit në mes bashkëmoshatarëve si dhe vendosja e këndeve të ndërmjetësimit ka treguar interesim të madh jo vetëm për shkollat përfituese të projektit por edhe të shkollat tjera, siç janë 5 shkollat e mesme të Mitrovicës. OJQ Mundësia ka organizuar trajnim për ndërmjetësimit në mes bashkëmoshatarëve për nxënësit e këtyre shkollave të mesme, si dhe kemi kërkesën që të vendosim këndet e ndërmjetësimit nëpër lokalet e shkollave, për çka jemi duke kërkuar mbështetjen nga donatorët potencial.

## 6. INSTITUTI PËR ZHVILLIM DHE INTEGIM – IZHI

Misioni i IZHI-it është që përmes hulumtimeve dhe përmes projekteve zhvillimore të edukimit jo formal të kontribuojmë në avancimin, integrimin dhe zhvillimin e shoqërisë. Qëllimi i Institutit është integrimi i grupeve të marginalizuara, për grupet të shoqërisë të cilat kanë nevoja dhe që është e domosdoshme. Gjithashtu, qëllim i organizatës është integrimi dhe zhvillimi ekonomik, përmes hulumtimeve të ndryshme të ndikojmë në ngritjen e vetëdijes qytetare, avokim dhe vetësidim tek institucionet, për ruajtjen dhe kultivimin e trashëgimisë kulturore, avansimi i pozitës së rinisë në proceset vendim-marrëse, punësimin, promovimi i drejtësisë sociale dhe kontributin në proceset e integritit të Kosovës në strukturat evropiane nëpërmjet vlerave kulturore, promovim dhe mbështetje e pjesëmarrjes së gruas në vendimmarrje dhe fuqizimin ekonomik të saj.



### **Shkollat partnere me të cilat kanë realizuar aktivitetet:**

- 1** SHFMU "Ali Kelmendi" në Barilevë, Komuna e Prishtinës.
- 2** SHFMU "Miladin Mitic", në fshatin Lapnasellë, Komuna e Graçanicës,
- 3** SHFMU "Nënë Tereza" në fshatin Vranidoll, Komuna e Prishtinës, me dy paralele në fshatin Tenezhdoll dhe fshatin Sharban.
- 4** SHFMU "Nexhmi Mustafa" në fshatin Besi, Komuna e Prishtinës, me dy paralele në fshatin Prugovc dhe në fshatin Rimanishtë.

### Ativitetet e realizuara:

- Takime informuese me palët e përfshira në projekt (Drejtorinë Komunale për Arsim, drejtorët e shkollave, stafin e mësimdhënësve dhe këshillat e prindërve)
- Përgatitjet e hulumtimit me psikologë dhe ekspertë të edukimit dhe dizajnimi i pyetësorëve anketues. Takime me drejtorët e shkollave dhe koordinimet rreth aktiviteteve.
- Hulumtimi në katër shkolla për përdorimin e teknologjisë nga fëmijët prej klasës së parë deri në nëntë.
- Procesimi i të dhënave dhe analiza hulumtuese nga psikologët.
- Organizimi i 4 punëtorive në 4 shkollat apo me stafin dhe drejtoritë e shkollave, me psikologë, ekspertë të arsimit dhe ekspertin e teknologjisë për diskutime dhe gjetjeve të hulumtimit
- Organizimi i një tryeze të rrumbullakët për publikin e gjetjeve të raportit
- Përgatitja dhe shpërndarja e broshurave informuese me këshilla nga psikologët

### REZULTATET NGA AKTIVITETET E REALIZUARA:



Ekipet e shkollave janë mobilizuar për aktivitetet e planifikuara si dhe janë ndarë vendet adekuate për realizimin e seancave të ndërmjetësimit. Janë angazhuar mësimdhënës dhe prindër në trajnimet katër ditore të organizuara nga KEC.



Janë çertifikuar në dy fusha specifike stafi i shkollave dhe prindërit në modulet e të drejtave të fëmijëve dhe ndërmjetësimi në mes bashkëmoshatarëve. Po ashtu, janë krijuar grupe ndërmjetësimi në shkollat partnere. Rreth 390 nxënës janë anketuar dhe janë përfshirë në hulumtim, apo 27%

e totalit të nxënësve në këto shkolla. Është arritë të marrim këshilla dhe sugjerimet gjatë punëtorive të organizuara në 4 shkollat partnere, janë dhënë rekomandimet dhe sugjerime rreth efekteve dhe pasojave nga përdorimi jo i drejt i internetit dhe pajisjeve teknologjike gjatë këtyre punëtorive. Janë nxjerr dy dokumente – (70 kopje) raporti me gjetjet dhe (2000 kopje) broshurat. Prindërit dhe të rinjtë janë informuar dhe këshilluar rreth përdorimit të pajisjeve të teknologjisë, përmes aktiviteteve dhe informatave në broshura.



## 7. OJQ CHILDPROOF/CIPOF

OJQ ChildrProof/CIPOF është Organizatë Joqeveritare/Joprofitabile, e cila merret me menaxhimin e kopshtit për fëmijë “MARGHERITA KIDS” në Zllakuqan. *CIPOF* është kryesisht e fokusuar në fushën e edukimit.

### Shkollat partnere me të cilat kanë realizuar aktivitetet:

- 1 SHFMU “Atë Shtifen Gjeqovi” Zllakuqan, Komuna e Klinës
- 2 SHFMU “Azem Bejta” Grabanicë, Komuna e Klinës
- 3 SHFMU “Dëshmoret e Qëndresës” Gllarevë, Komuna e Klinës
- 4 SHFMU “Esat Mekuli” Cerovikë, Komuna e Klinës



## Aktivitetet e realizuara:

- Takime për krijimin e grupeve punuese, hartim të planit të veprimit për zgjidhje paqësore të konflikteve.
- Angazhimi i një facilituesi për ofrimin e asistencës teknike në hartimin e planit të veprimit.
- Organizimi i 4 fokus grupeve për identifikimit të problematikave që do të përfshihen në planin e veprimit.
- Organizimi i një punëtorie me përfaqësues të institucioneve, OJQ, shkolla për draftimin e planit të veprimit.
- Lancimi i planit të veprimit në nivel komunal.
- Organizimi i tryezave për themelimin e grupeve ndërmjetësuese për zgjidhje paqësore të konflikteve.
- Organizimi i trajnimeve për ngritje kapacitetesh të mekanizmit ndërmjetësues.
- Organizimi i sesioneve informuese/debateve në shkolla, për promovimin e grupeve ndërmjetësuese.
- Prodhimi i një video sensibilizuese për zgjidhjen paqësore të konflikteve në shkolla.
- Prodhimi i broshurave mbi parandalimin e dhunës në shkolla, krijimin e mjediseve miqësore dhe të padhunshme dhe zgjidhjen paqësore të konflikteve.
- Promovimi i aktiviteteve të projektit përmes mbulesës mediatike në portale informative, radio dhe televizione lokale.
- Organizimi i një konference përmbyllëse të fushatës dhe projektit, në nivel komunal.

## REZULTATET NGA AKTIVITETET E REALIZUARA:



Takime për krijimin e grupeve punuese, hartim të planit të veprimit për zgjidhje paqësore të konflikteve.



Organizimi i një punëtorie me përfaqësues të institucioneve, OJQ, shkolla për draftimin e planit të veprimit.



Angazhimi i një facilituesi për ofrimin e asistencës teknike në hartimin e planit të veprimit.



Lancimi i planit të veprimit në nivel komunal.



Organizimi i 4 fokus grupeve për identifikimit të problematikave që do të përfshihen në planin e veprimit.

## 8. OJQ “QENDRA PER DEPOLITIZIMIN E SHOQERISE KOSOVARE QDSHK” – KAMENICË NGO “CENTAR ZA DEPOLITIZACIJU KOSOVSKOG DRUŠTVA CDKD” - KAMENICA

### Shkollat partnere me të cilat kanë realizuar aktivitetet:

- 1 SHFMU “Desanka Maksimović”, me paralele të ndara në Ajnovc, Bosc, Berivojc, Komuna e Kamenicës
- 2 SHFMU “Brastvo” me paralele të ndara në Strezovc, Carevc dhe Boljevc, Komuna e Kamenices
- 3 SHFMU „Veljko Dugošević”, në Ranillug me paralele të ndara në Korminjan dhe Domorovc.
- 4 SHFMU “Trajko Perić”, Ropotovë e madhe me paralele të ndara në Rajanovc, Pančelo-Tomance dhe Drenovc, Komuna Ranillug.



## Aktivitetet kryesore të këtij projekti kanë qenë:

- Aktiviteti 1. Identifikimi i gjendjes aktuale në shkollat në drejtimin e politikave për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës. Janë realizuar intervista me të gjithë drejtorët e shkollave, përgjegjësit e klasës dhe mësimit. Gjithashtu janë zhvilluar pyetësor me nxënësit në bashkëpunim me mësuesit, ku janë mbledhur të dhënat e duhura për nxënësit përmes analizës së pyetësorit dhe në bazë të përmbajtjes së tij. Duke marrë parasysh të dyja metodat e realizuara u krijua një pasqyrë reale e situatës në shkollë në çështjen e të drejtave të fëmijëve.
- Aktiviteti 2. Realizimi i forumeve të diskutimeve në shkollë, sesioneve trajnuese dhe seminareve për të drejtat e fëmijëve; në këtë aktivitet i cili është bërë pas një plani studimi për të gjitha katër shkollat në një panel diskutimi me stafin mësimdhënës dhe stafit mbështetës, aty u prezantuan disa tema të cilat do të diskutohen, por gjithashtu t'i rikujtojnë të gjithë edhe detyrimet ligjore për respektimin e të drejtave të fëmijës. Në këto panele diskutimi erdhi si konkludim për realizimin e disa veprimeve specifike në disa nivele dhe drejtime në ngritjen e vetëdijes për të drejtat e fëmijëve përmes një shumëllojshmërie të aktiviteteve për nxënësit dhe mësimitdhënësit, të cilat do të na çojnë në një fazë të re të aktivitetit dhe rritjen e ndërgjegjësimit të komunitetit të përgjithshëm si në shkollë dhe më gjerë.
- Aktiviteti 3. Realizimi i punëtorive krijuese me nxënësit për të drejtat e nxënësve, përmes ekspozitave të arteve figurative, projektimit të filmave të shkurtër dhe orëve letrare. Në kuadër të këtyre aktiviteteve janë planifikuar një varg i nën-aktiviteteve për ndikimi të përgjithshëm në disa fusha për ndërgjegjësimin dhe forcimin e komunitetit të gjerë. Pra, u realizuan aktivitetet së bashku me mësimitdhënësit për të krijuar punëtori kreative nga fusha të ndryshme. Po ashtu janë zhvilluar edhe punëtori në aspektin letrar, vizuale dhe filmike me një temë të vetme të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve. Në këto aktivitete janë përfshirë një numër i madh i klasave nga çdo shkollë dhe u ofruan disa llojë shpërblimesh si një nxitje për angazhim më të madh në të gjitha tre fushat e aktiviteteve të realizuara. Gjithashtu kemi përfshirë një stacionin rajonal televiziv që do të transmetojë aktivitetet për të siguruar mbulueshmëri më të madhe dhe efekt më të gjerë në shkollat tjera dhe komunitetet që nuk janë të përfshira.
- Aktiviteti 4. Mbështetje teknike dhe këshillimore për shkollat për krijimin e mekanizmave të përhershëm operativ për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Si pjesë e këtyre aktiviteteve, në fazën përfundimtare të projekti së bashku me të gjithë akterët në shkollë dhe jashtë saj dhe përfshirjen e prindërve dhe këshillit akademik është ofruar asistencë teknike dhe këshilluese në përgatitjen e dokumenteve, protokolleve, dhe mekanizmave të tjera që do të përmirësojë ndjeshëm punën për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në të gjitha shkollat. Ndiqja jonë teknike ishte në përpilimin e

Kodit të Sjelljes që do të jetë i paraqitur në të gjitha klasat, tek kujdestarët e klaseve dhe nxënësve. Krijimi i paneleve informuese dhe kutive për ankesa. Roli këshillues do të jetë zhvillimi i protokolleve dhe krijimi i ekipeve kundër dhunës në pajtim me konventat dhe ligjet për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

## REZULTATET NGA AKTIVITETET E REALIZUARA:



Rezultati 1. Detaje dhe faktet e shkollave, pas hulumtimeve që janë bërë në temën e respektimit të të drejtave të fëmijës. Ky rezultat ka ardhur nga hulumtimi që kemi punuar në dy mënyra: përmes intervistave me nxënësit, menaxhmentin e shkollave, mësuesit dhe prindërit dhe përmes pyetësorëve që kemi punuar me të gjithë akterët e sipërpërmendur në të katër shkollat. Në këtë mënyrë morëm informata për gjendjen e shkollave në fushën e të drejtave dhe mekanizmat për mbrojtjen e fëmijëve si dhe për promovimin e tyre.



Rezultati 2- Në kuadër të këtij aktiviteti, kemi shënuar rezultatet e mëposhtme: - Ne kemi ngritur kapacitetet e mësimdhënësve në shkollat partnere rreth mbrojtjes dhe promovimit të drejtave të fëmijës, janë inkurajuar menaxhmenti i shkollës për t'u angazhuar për të zgjeruar njohuritë dhe përgjegjësitë e tyre në promovimin dhe mbrojtjen e fëmijëve. Po ashtu është hartuar dhe miratuar një plan i përbashkët i punës dhe dinamikës së tij në kryerjen e punëtorive dhe garave të nxënësve nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme në temën e promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve.



Rezultati 3. Përmes punëtorive me nxënës në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve është forcuar ndjeshëm ndërgjegjësimi i komuniteteve të nxënësve në shkolla, janë zhvilluar kapacitetet dhe njohuritë tek shumica e nxënësve përgjegjësitë dhe respektimit të të drejtave të tyre nga të gjithë akterët në shkolla (moshatarët e tyre, mësuesit, personelin mësimdhënës dhe komunitetin) - është zhvilluar një shpirt konkurrues në mesin e nxënësve të klasave të larta të shkollave filllore dhe punimet më të mira janë shperblyer, si një nxitje për pjesëmarrje aktive, por edhe një kuptim më të mirë të temave në fushën e të drejtave të fëmijëve.



Rezultatet 4. Gjatë realizimit të aktiviteteve është ofruar asistencë teknike për të gjitha shkollat e synuara duke krijuar për të gjitha shkollat tabela informuese që do të përdoren vetëm për prezantimin e veprave për të drejtat e fëmijëve dhe gjithashtu për të gjitha shkollat kutitë për ankesat dhe sugjerimet e nxënësve. Po ashtu vazhdimisht shkollat janë këshilluar të ndërtojnë mekanizma dhe protokolle, si dhe formimin e ekipeve për monitorimin e respektit dhe promovimit të të drejtave të fëmijëve, ekipit të Parandalimit të dhunës ndërmjet moshatarëve dhe diskriminimit.

## 9. OJQ „FEMINAE“ PRIZREN

### Shkollat partnere me të cilat kanë realizuar aktivitetet:

- 1 SHFMU „Ekrem Rexha –Drini“ Ljubizhdë, Komuna e Prizrenit
- 2 SHFMU „Meto Bajraktari“ Reçanë, Komuna e Prizrenit
- 3 SHFMU „ Planjane“ Planjane, Komuna e Prizrenit
- 4 SHFMU „Anadolu“, Mamushë, Komuna e Prizrenit



## Aktivitetet kryesore të këtij projekti kanë qenë:

- Debatet e hapura me prindër
- Organizimi i takimeve grupore me prind dhe formimi i Forumit të fëmijëve
- Vizitat inicuese të fëmijeve tek institucionet
- Përgaditja dhe organizimi i Studiove të hapura në radio dhe TV
- Ofrimi i këshillave plotësuese për fëmijët
- Përfshirja e fëmijëve dhe vizitat në shkolla të ndryshme multietnike
- Trajnimi i nxënësve për ndërmjeticim
- Organizimi i aktiviteteve ndëretnike të fëmijëve në katër shkolla:
- Fëmijët dhe Toleranca – E ardhmja pa dhunë
- Krahas këtyre gjatë aktiviteteve tërë ditore kemi pasur edhe prezantime në katër shkolla me tema “Interneti”, “Bontoni”, “Toleranca Ndëretnike”

## REZULTATET NGA AKTIVITETET E REALIZUARA:



Gjatë aktivitetit tërë ditorë me temën „Bontoni“ i cili edhe nga vetë pjesëmarrësit u zgjodh si më atraktivë sepse nxiti debate dhe praktika nga jeta e përditshme, fëmijët dhe të gjithë pjesëmarrësit e gjetën vetën duke debatuar për përditshmërinë nga jeta shkollore. Githashtu, përfundam me disa rregulla që duhen të jenë të shkruara nëpër korridore të shkollave për sensibilizimin edhe të nxënësve të tjerë. Kjo u vlerësua edhe nga vetë pjesëmarrësit si aktiviteti më i qëlluar dhe edukativ.



Do veçonim këtë aktivitet sepse fëmijët, pjesëmarrës ndiheshin të lirë të ndajnë përvojat e tyre me njëri-tjetrin edhe pse për të gjithë ishte hera parë mbas disa aktivitete të lirohen dhe të tregojnë historitë e tyre ndoshta edhe më tepër personale, por në të njetën kohë u krijonte edhe atmosferën shumë pozitive /miqësore mes tyre.



Gjatë vizitave të ndërsjella nëpër shkolla vetë nxënësit pjesëmarrës shprehnin interesim dhe pyetje për këto rregulla dhe këshilla që erdhën nga vet nxënësit për të drejtat e fëmijës nga nxënësit tjetër në shkollë.

## 10. OJQ "PROGRAMI PËR TË DREJTAT CIVILE" (CRP/K)

Programi për të Drejtat Civile (CRP/K), Prishtinë, është organizatë që ofron ndihmë juridike dhe këshillim për të kthyerit, azilkërkuesit, personat e zhvendosur në Kosovë, personat në rrezik të pashtetësisë dhe personat të cilët konsiderohen të ndjeshëm në realizimin e të drejtave të tyre.

### Shkollat partnere me të cilat kanë realizuar aktivitetet:

- 1 SHFMU "JETA E RE", GREME, KOMUNA E FERIZAJIT
- 2 SHFMU "BESIM REXHEPI", KOMOGLLAVË, KOMUNA E FERIZAJIT
- 3 SHFMU "24 Dhjetori", TERN, KOMUNA E FERIZAJIT
- 4 SHFMU "KONSTANTIN KRISTOFORRIDHI", NERODIME, KOMUNA E FERIZAJIT





## Aktivitetet

- Ndër aktivitetet e para është realizuar trajnimi për të Drejtat e Njeriut dhe Ndërmjetësimin midis bashkëmoshatarëve i realizuar nga KEC dhe forumZFD si dhe stafi i projektit për mësimdhënës, prindër dhe nxënës në katër shkollat e zgjedhura të projektit. Dy mësimdhënës, dy prindër, dy nxënës dhe drejtori i shkollës kanë marrë pjesë në trajnimin për të drejtat e fëmijëve dhe ndërmjetësimin midis bashkëmoshatarëve, përgjatë dy ditëve. Pjesa e trajnimit për të Drejtat e Njeriut është bazuar në njohuritë teorike nga Konventa për të Drejtat e Fëmijës, ndërsa metodat dhe teknikat e Ndërmjetësimit, janë zhvilluar në nivel praktik bazuar në metodat alternative të zgjidhjes së konfliktit të nxjerra nga dokumente të ngjashme ligjore.
- Vizita studimore për t'u njohur me procesin e ndërmjetësimit midis bashkëmoshatarëve në Republikën e Shqipërisë dhe në Republikën e Maqedonisë Veriore, për Drejtorët e Shkollave të projektit. Drejtorët e shkollave respektive kanë pasur mundësinë që në mënyrë praktike të mësojnë se si funksionon ndërmjetësimi në vendet ku, tanimë mekanizmi i ndërmjetësimit është funksional dhe rëndësinë e tij në zgjidhjen e problemeve midis bashkëmoshatarëve me burimet brenda shkollës.
- Takimet e rregullta të përbashkëta me mësimdhënës, prindër, nxënës, dhe drejtor nga katër shkollat e përfshira, për hartimin e planit të veprimit. Takime të përziera janë organizuar me qëllim të përfshirjes së të gjitha grupeve dhe për shkak të funksionit të rëndësishëm që ndërmjetësimi dhe zgjidhja paqësore e konflikteve në nivel të shkollës e ka, dhe dakordimin nga të gjitha grupet e përfshira.

## REZULTATET NGA AKTIVITETET E REALIZUARA:



Takimet e përziera, mësimdhënës, nxënës, prindër, dhe drejtorë shkolle kanë kontribuar shumë në definimin e përbashkët të pikave kryesore të Planit të Veprimit dhe në zotërimin e përbashkët të procesit të ndërmjetësimit për t'u përcjellur dhe realizuar në shkollat e tyre përkatëse.



Vizita studimore kanë rezultuar me pëfitim për pjesëmarrësit, meqenëse ata nga praktikatat e dy vendeve të vizituara kanë marrë shembujt të cilët janë duke i praktikuar tanimë.



Trajnimi është zhvilluar në baza të bashkëveprimit, për të shërbyer si një udhërrëfyes për hapat të cilët shkollat e përfshira duhet t'i ndjekin në themelimin e Mekanizmit të Ndërmjetësimit dhe në procedurat e ndërmjetësimit.





**PJESA III**

## Aktivitetet që janë realizuar kanë fuqizuar edhe më tepër rolin e OJQ-ve dhe shkollave përfituese në projekt.

Në kuadër të projektit janë realizuar aktivitetet si në vijim:

**Ngritja e një platforme on-line** për ngritjen e vetëdijes për të drejtat e fëmijës dhe masat për mbrojtjen e tyre.

Platforma ka pasur për qëllim të sjellë informacion të përditësuar në lidhje me projektin dhe është populluar me materiale informuese miqësore për lexuesit/mësuesit, prindërit, fëmijët dhe publikun e gjerë, duke përfshirë fletëpalosjet, broshurat, video klipet dhe materiale të tjera në këtë fushë.

Kjo fushë ka vazhduar të jetë një ndër pikat kryesore të projektit duke u pasuruar me publikime shtesë të zhvilluara nga OJQ-të përfituese ([www.childrights-ks.org](http://www.childrights-ks.org))

Gjithashtu, është hartuar plani i veprimit për vizibilitet të projektit dhe është formuar grupi i mbyllur në faqen e facebook-ut të projektit me qëllim të nxitjes së debateve dhe zgjidhjes së konflikteve në shkollat përfituese me qëllim të mbrojtjes së fëmijëve.

### Zhvillimi i materialeve informuese për fëmijë, prindër, mësues dhe publikun e gjerë.

Është zhvilluar një seri e materialeve të ndryshme për të komunikuar me fëmijët, mësuesit, prindërit dhe publikun e gjerë mbi temën e të drejtave të fëmijës dhe mbrojtjen e fëmijëve që mund të përshtaten në kontekste të ndryshme të vendit.

**Organizimi i garës mediale** për artikullin më të mirë për të drejtat e fëmijës.

Në fund të vitit 2017 dhe 2018, është realizuar aktiviteti i garës mediale, për artikullin më të mirë për të drejtat e fëmijës. Ky aktivitet u organizua në bashkëpunim me KOMF – koalicioni i OJQ-ve për mbrojtjen e fëmijëve dhe pas vendimit të Komisionit për procesin e përzgjedhjes dhe shpërblimeve, u organizua edhe ceremonia e ndarjes së çmimeve

### Zgjedhja e 10 OJQ-ve lokale për të punuar me 40 shkolla të viseve rurale.

Projekti ka bërë thirrje për OJQ-të lokale që të ndihmojnë në komunitetet e shkollave dhe të zbatojnë masa për mbrojtjen efikase të të drejtave

të fëmijës, me fokus në ndërmjetësimin e bashkë-moshatarëve dhe zgjidhjen paqësore të konflikteve. Grupi i synuar ishin 40 shkolla fillore të vendosura në zonat jo-urbane që u shërbejnë komuniteteve me qasje të kufizuar në shërbimet themelore si shëndetësia dhe arsimi, infrastruktura e dobët publike, mungesa e mjediseve sportive dhe kulturore, mundësitë e kufizuara për punë dhe të ngjashme. Secili aplikant ka kërkuar partneritet me së paku 4 shkolla fillore jo-urbane brenda zonës së saj të veprimtarisë për të zbatuar një projekt ide lidhur me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve përmes ndërmjetësimit të kolegëve dhe zgjidhjes paqësore të konflikteve.

## Takimet nismëtare

Janë realizuar dhjetë takime nismëtare, një për çdo OJQ / shkolla. Me anë të këtyre takimeve, është bërë sensibilizimi i gjithë komunitetit për projektin dhe rëndësinë që ka.

## Takimet e komitetit drejtues

Përveç përfaqësuesve nga KEC dhe forumZFD, MASHT gjithashtu është e përfshirë në Komitetin Drejtues të Projektit (KDP). Gjatë projektit janë realizuar 7 takime. Kjo me qëllim të informimit sa më korrekt të aktiviteteve në projekt nga përfituesit e projektit PPCR.

## Organizimi i trajnimeve për të Drejtat e Fëmijës dhe Ndërmjetësimin për OJQ-të përfituese, nxënësit, prindërit dhe mësime të mësimdhënësit

Programi gjashtë ditor i trajnimit nisi me trajtimin e koncepteve themelore mbi të drejtat e njeriut dhe ndërmjetësimin, bazuar në parimet e Konventës për të Drejtat e Fëmijës. Më tutje, u trajtuan aspekte të përgjithshme të të drejtave të njeriut, aspektet e veçanta si diskriminimi, ngacmimet dhe dhuna ndaj fëmijëve, si dhe identifikimi i palëve dhe rrugëve për evitim dhe adresim të këtyre rasteve.

Trajnimi ndoqi metodologjinë e të mësuarit aktiv, me aktivitete që bazohen në ciklin e të mësuarit përmes përvojës. Duke marrë parasysh se pjesëmarrësit u angazhuan në ofrimin e programit të trajnimit me ekipet shkollore, më shumë rëndësi ia kushtua elementeve themelore të shkathtësisë të trajnerit dhe u dhanë këshilla e ide për pjesëmarrësit. Të ftuar ishin gjithsej 30 pjesëmarrës (3 nga secila OJQ përfituese) prej të cilëve gjithsej u certifikuan 29 pjesëmarrës, prej tyre 23 femra dhe 6 meshkuj.

Më pas, u organizuan edhe 40 ditë trajnime me nxënësit, mësime të mësimdhënës e prindër ku gjithsej pjesëmarrës ishin: mësime të mësimdhënës 159 pjesëmarrës (58 meshkuj dhe 95 femra). Prindër 16 pjesëmarrës (9 meshkuj dhe 7 femra) dhe nxënësit: 96 pjesëmarrës (24 djem dhe 72 vajza).

Trajnimet për shkollat përfituese ishin të ndara në dhjetë lokacione të ndryshme. Kjo për arsyen që secila nga OJQ-të përfituese ishte e obliguar të ndihmojë rreth organizimit të trajnimeve për shkollat e veta përfituese. Andaj, me ndihmën e OJQ-ve u organizuam edhe trajnimet të cilat ishin të ndara në dy module. Moduli i parë dy-ditor kishte të bëjë me trajnimin rreth “Të Drejtat e Fëmijës, ndërsa moduli i dytë dy-ditor me Ndërmjetësimin në shkolla.

## Vizitat studimore

Në kuadër të projektit “Promovimi dhe Mbrojtja e të Drejtave të Fëmijës” u realizua vizita studimore me përfaqësues të Organizatave Jo-Qeveritare që janë përfitues të projektit PPCR dhe drejtorët-mësimdhënësit e shkollave përfituese të projektit. Për të kuptuar me të vërtetë se si ndikon ndërmjetësimi në një shkollë për zgjidhjen e konflikteve, këtë më së miri mund ta kuptojmë nga shkollat që kanë zbatuar ndërmjetësimin e shkollës. Ndërsa, ndërmjetësimi në shkolla është relativisht i ri në Kosovë, nuk ka shumë shkolla që mund të demonstrojnë efektin e ndërmjetësimit. Megjithatë, në Maqedoni dhe në Shqipëri ka shkolla të tilla, andaj edhe u realizua një vizitë e tillë studimore në mënyrë që si grup të mësojmë forma të ndryshme të ndërmjetësimit.

Në Maqedoni, zyra forumZFD Programi në Shkup ka krijuar dhe institucionalizuar ndërmjetësimin e shkollave për më shumë se nëntë vjet. Shkollat në

të dy vendet kanë mbledhur një përvojë të mirë dhe praktika të mira në ndërmjetësimin e shkollës, nga të cilat përfituan OJQ-të dhe shkollat e Kosovës. Në Maqedoni, Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka njohur rëndësinë e ndërmjetësimit në shkollë dhe ka krijuar një departament të dedikuar posaçërisht për këtë temë. Kështu, Shqipëria dhe Maqedonia ishin shembuj për praktikën më të mira në lidhje me edukimin e paqes dhe ndërmjetësimin në shkolla.

Vizita e parë u organizua me OJQ-të: FEMINAE, CDKD, CIPOF, CRPK dhe IZHI që përfshijnë shkollat e komunave: Prishtinë, Prizren, Kamenicë, Klinë dhe Ferizaj. Vizita e dytë u realizua me OJQ-të: MUNDËSIA, QESHU-SMILE, ECF, SHPRESA E JETËS dhe FIT që përfshijnë shkollat e komunave: Prishtinë, Mitrovicë, Gjakovë, Pejë dhe Viti.

### Institucionet nikoqire të këtyre

#### vizitave studimore ishin:

- OJQ “Fëmijët janë e ardhmja”, Tiranë (3 përfaqësues)
- Shkolla fillore “Qamil Guranjaku”, Elbasan (11 përfaqësues)
- Shkolla fillore “Vëllezërit Milladinov”, Strugë (4 përfaqësues)
- Shkolla fillore “Europa”, Elbasan (4 përfaqësues)
- Ministria e Arsimit, Shkup (4 përfaqësues)
- Shkolla e mesme “Niko Nestor”, Strugë (6 përfaqësues)

Pas realizimit të vizitave studimore me të dy grupet, u organizua edhe një takim i përbashkët me qëllim të shkëmbejnë përvojat e tyre në mes vete pasi që vizitat nëpër institucione kanë qenë të ndryshme me grupet.

## **Përkrahja e OJQ-ve në realizim të projekteve**

Me qëllim të përkrahjes së vazhdueshme të OJQ-ve në realizim të projekteve të tyre, projekti organizon takime të rregullta dy mujore ku edhe diskutohen të gjitha aktivitetet nga secila OJQ. Gjithashtu, monitorimet në shkollat përfituese janë pjesë e pandarë e punës gjë që lehtëson edhe bashkëpunimin në mes të shkollave dhe OJQ-ve. Me përkrahjen e OJQ-ve, janë themeluar 40 kënde të ndërmjetësimit në shkollat përfituese dhe si rezultat i trajnimeve dhe themelimit të këtyre këndeve, shkollat respektivisht, nxënësit ndërmjetësues kanë arritur të ndërmjetësojnë në 110 raste të ndryshme duke ndihmuar kështu bashkëmohatarët e tyre dhe duke krijuar ambient sa më miqësor mes veti.

## **Planet për të ardhmen**

Aktivitetet që u realizuan dhe vazhdojnë të realizohen gjatë vitit 2019 do ta fuqizojnë edhe më tepër rolin e OJQ-ve dhe shkollave përfituese në projekt.

Meqë publikimi i praktikave të mira u punua, do të jenë shtytje e mirë për shkollat në Kosovë. Pritet që praktikatat e mira nga shkollat do të ndikojnë në qëndrimet e njerëzve dhe të zhvillojnë avancim në masa për mbrojtjen e fëmijëve në mjediset shkollore dhe më gjerë në shoqëri.

Projekti do të përmbyllet me organizimin e Konferencës Rajonale për të Drejtat e Fëmijës e cila pritët të organizohet në muajin shtator 2019, ku do të paraqiten rezultatet e projektit tek palët relevante të interesit dhe tek publiku i gjerë duke prezantuar materialet dhe metodat e zhvilluara në kuadër të projektit.







**PJESA IV**

## Dokumentet, materialet dhe burimet nga interneti të dobishme për aktivitete ndërmjetësimi dhe promovimin e zgjidhjeve paqësore të konflikteve:

1. Rregullorja e Qeverisë së Republikës së Kosovës (QRK)- nr. 21/2013 për Protokollin për parandalimin dhe referimin e dhunës në institucionet e arsimit para universitar. [http://www.childrightssks.org/site/assets/files/1450/education\\_comes\\_first\\_newspaper.pdf](http://www.childrightssks.org/site/assets/files/1450/education_comes_first_newspaper.pdf)
2. Udhëzuesi për zbatimin e Rregullores së QRK- nr. 21/2013 për protokollin për parandalimin dhe referimin e dhunës në institucionet e arsimit para universitar <http://www.childrights-ks.org/site/assets/files/1430/broshura-1.pdf>
3. Doracaku për parandalimin e dukurive negative në shkolla të mesme të larta, MASHT, Prishtinë 2014 [https://www.childrights-ks.org/site/assets/files/1432/broshura\\_ecf-2.pdf](https://www.childrights-ks.org/site/assets/files/1432/broshura_ecf-2.pdf)
4. Doracak për ekipet ndërmjetësuese mes bashkëmoshtarëve, MASHT, Prishtinë 2014 [https://www.childrights-ks.org/site/assets/files/1426/cipof\\_pdf\\_manual01-10\\_2018.pdf](https://www.childrights-ks.org/site/assets/files/1426/cipof_pdf_manual01-10_2018.pdf)
5. Manual didaktik për parandalimin e dhunës, Botuar nga Save the Children në Kosovë, Prishtinë 2014 <https://www.childrights-ks.org/site/assets/files/1425/broshura-izhi.pdf>

### Burime nga interneti:

<https://www.childrights-ks.org>

<https://tedrejtatefemijeve.wordpress.com>

[https://www.childrights-ks.org/site/assets/files/1412/doracak\\_per\\_parandalimin\\_e\\_dukurive\\_negative\\_per\\_shkolla\\_te\\_mesme\\_te\\_larta.pdf](https://www.childrights-ks.org/site/assets/files/1412/doracak_per_parandalimin_e_dukurive_negative_per_shkolla_te_mesme_te_larta.pdf)

<https://www.childrights-ks.org/sq/publikime/>

Ky publikim është botuar me asistencë të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e Qendrës për arsim e Kosovës - KEC dhe forumZFD dhe në asnjë mënyrë nuk mund të paraqes pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

